

**PROTOKOLLI I PUNËS PËR PROFESIONISTËT PRANË
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE
FAMILJEN**



BASHKIA KORÇË

Ky protokoll u përgatit me kontributin e organizatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS¹ dhe Bashkisë Korçë, në kuadër të projektit: “Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror”, në Bashkinë Korçë dhe financuar nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet shoqatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS dhe Bashkisë Korçë e lidhur me datë 13.07.2021 me nr.prot 6013 dhe nr.101 prot, (NISMA) dt.15.07.2021 për zbatimin e projektit “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) me mbështetje të Fondit Social (2021-2023), ekipi i Nisma ARSIS ka hartuar dokumentin e protokollit të punës për punonjësit e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen.

Hartimi i dokumentit bazohet në nenin 4 të marrëveshjes dhe në zbatim të aktivitetit “*Hartimi i të gjitha politikave të mbrojtjes së klientëve (përfituesve) dhe punonjësve të shërbimit.*”

Protokolli është hartuar në shtator 2021 dhe është testuar në pilotim deri në muajin qershor 2022. Në muajin Korrik 2022, ky dokument paraqet të reflektuar gjetjet gjatë vënies në zbatim si dhe sygjerimet e punonjësve të shërbimeve mbështetëse të fëmijës dhe familjes si dhe ndryshimet legislative.

Përmbajtja

Shkurtime	4
-----------------	---

¹ Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS ka kontribuar me eksperiencën e saj dhe mësimet e nxjerra përgjatë procesit të konsulencës kombëtare pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për çështje të deinstitutionalizimit

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

Hyrje	5
Përshkrimi i Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjet	6
Roli i Ekipit të NISMA ARSIS	7
Kuadri ligjor	8
Parimet	9
Profilet e përfituesve	11
Menaxhimi dhe struktura e shërbimit	12
Mjedisi dhe kushtet fizike ku ofrohen SHMFF	14
Shërbimet që ofrohen pranë SHMFF	14
Organizimi i punës për ofrimin e shërbimeve	19
<i>Metodologjia e ofrimit të shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen</i>	20
Hapi 1_ Identifikimi, regjistrimi dhe pranimi në shërbim	20
Hapi 2_ Vlerësimi	21
Hapi 3_ Planifikimi	25
Hapi 4_ Zbatimi dhe Ndjekja e Planit	26
Hapi 5_ Rishikimi i Planit dhe ecurisë	26
Hapi 6_ Mbyllja e rastit	26
Dokumentimi i procesit të ofrimit të shërbimeve	27
Hartëzimi i shërbimeve	28
Kodi i etikës dhe konfidencialiteti	28
Mënyrat/procedurat e marrjes së shërbimeve të specializuara	29
Mënyrat /procedurat për marrjen e shërbimit të kujdesit në shtëpi (domiciliary services)	29
Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve	30
Aneke:	33
Aneksi 1- Rolet dhe përgjegjësitë e ekipit të SHMFF	33
Përgjegjësi/sja i/e Shërbimit në SHMFF	33
Psikologu/ia për të rritur	33
Psikologu/ia për fëmijë	34
Punonjësi/ja Social/e për Fuqizimin e Familjes	35
Punonjësi/ja Social/e për Klasat e Prindërimit	35
Kujdestare Shtëpie për Familjet e Fëmijëve në IPSH	36
Kujdestare Shtëpie për Kujdesin Alternativ dhe familjet me PAK	37

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

Sanitar.....	37
Aneksi 2: Nevojat e identifikuar dhe kriteret e aksesit në shërbim	38
Nevoja me rëndësi të lartë	39
Nevoja me rëndësi të mesme	40
Nevoja me rëndësi të ulët.....	41
Aneksi 3: Formularët e vlerësimit.....	42
Aneksi 4 – Formular i vizitës në familje	46
Aneksi 5- Fleta e ditarit	50
Aneksi 6: Formulari i raportimit për fëmijën në nevojë për mbrojtje.....	51
Aneksi 7- Formular për identifikimin proaktiv.....	52
Aneksi 8- Plani i ndërhyrjes për fuqizimin e familjes	54
ANEKS 9: Shërbimi Emergjent për Mbrojtjen e Fëmijëve gjatë dhe Pas Orarit Zyrtar	58

Shkurtime

Shkurtime	Emri i plotë i institucionit apo strukturës
SHMFF	Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen

Protokoll i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

**BASHKIA KORÇË**

NJVNR	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
NJQV	Njësia e Qeverisjes vendore
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale
NISMA ARSIS	Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS
EMD	Ekip multi disiplinuar
KB	Këshill Bashkiak
GTN	Grup Teknik Ndërsektorial
MR	Menaxhim Rasti
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuar
ZVA	Zyra Vendore Arsimore
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit

Hyrje

Ngritja e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen synon të mbështesë familjet në terma afatgjatë dhe të qëndrueshëm për të siguruar një mjedis të përshtatshëm për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Problematikat dhe sfidat me të cilat familjet në nevojë përballen, shpesh gjenerojnë si të vetmen zgjidhje institucionalizimin e fëmijëve, por tërësia e shërbimeve të integruara dhe të mirëkoordinuara të SHMFF ndihmon familjen të gjejë alternativa të tjera përveç kujdesit rezidencial dhe kontribuon në

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja biologjike. Duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh, SHMFF ofron mundësi për fuqizimin e familjes duke promovuar sigurinë, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve dhe të rinjve në komunitetin ku jetojnë.

Sipas vlerësimit të nevojave në Bashkinë Korçë dhe në përputhje me Ligjin për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë nr. 121/2016, Paktit Social të firmosur me Kryeministrin, Bashkia Korçë nuk kishte ende një strukturë të specializuar, multidimensionale e cila mundëson fuqizimin e familjeve. Një nga prioritetet strategjike të Planit Social të Bashkisë Korçë të miratuar, është ndërtimi i “shportës së shërbimeve” të kujdesit shoqëror ku përfshihet: përmirësimi i shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror si dhe ngritja e shërbimeve të reja. Në një kontekst ku mungojnë shërbimet mbështetëse për familjen, të cilat janë thelbësore për të siguruar ribashkimin e qëndrueshëm të fëmijëve me familjet biologjike ose familjet kujdestare me lidhje gjaku është mjaft me rëndësi ngritja e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjet (SHMFF).

Protokolli i punës për SHMFF është një dokument që i shërben profesionistëve, pjesë e ekipit të Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen dhe ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të fëmijëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Protokolli përmban:

- Llojet e shërbimeve që do të ofrohen
- Kategorinë e përfituesve të shërbimeve
- Procedurat e kërimit të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror - Roli dhe përgjegjësitë e strukturës dhe profesionistëve që duhet të ofrojnë këto shërbime

Përshkrimi i Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjet

Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen, bëjnë pjesë në sistemin e integruar dhe të organizuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror², të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse si punonjës socialë, psikologë, profesionistë të tjerë, etj. SHMFF është subjekt publik dhe ofron përfitime dhe lehtësi me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të fëmijëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

SHMFF janë një ndërthurje ndërmjet shërbimeve³ parashoqërore, shërbimeve në qendrat komunitare, shërbimeve të specializuara dhe shërbimeve të emergjencës dhe funksionojnë në përputhje me standardet e shërbimeve komunitare shumëdisiplinore⁴. SHMFF ofrohen nga një strukturë me të njëjtin

² Ligji 121/2016 Për Shërbimet e Kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë –përkufizime_“Shërbime të kujdesit shoqëror” është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

³ Neni 8 Llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, Ligji 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”⁴ Udhëzim, Nr. 911, datë 27.12.2018 Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

mekanizëm financimi si institucionet rezidenciale, ku profesionistët e punësuar funksionojnë si pjesë e një ekipi multidisiplinar.

Ekipi i SHMFF punon për t'i siguruar mbështetje fëmijës, familjes dhe shërbimeve të kujdesit alternativ siç parashikohet në legjislacion në nivel vendor⁴ dhe qendror. Këto shërbime janë të orientuara drejt nevojave reale të familjeve, të identifikuar në të gjithë shtrirjen territoriale në nivel qarku duke ngritur një model shumëdimensional shërbimofrues. Metodologjia e ndërhyrjes synon të sigurojë mirëqënien dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijës për t'u rritur dhe zhvilluar në një mjedis familjar të shëndetshëm. Shërbimet e integruara brenda kësaj strukture do të përmbajnë programe dhe ndërhyrje proaktive duke filluar nga ndërgjegjësimi, referimi drejt strukturave përkatëse, mbështetje direkte psikosociale, mbështetje ligjore, administrative, mbështetje për aftësim profesional, rritje e kapaciteteve prindërore deri në ngritjen e ekipit të profesionistëve për ofrimin e shërbimeve të specializuara, kujdes afatshkurtër në shtëpi dhe pilotimin e modelit të kujdestarisë alternative profesionale.

SHMFF është një strukturë në varësi dhe menaxhim të Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social në Bashkinë Korçë. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Korçë dhe Shoqatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, ekipi i SHMFF është nën supervizionin profesional të ekipit të NISMA ARSIS dhe do të mbështetet për t'u njohur më tej me modelin e ofrimit të shërbimeve dhe zbatimin e tij në praktikë. SHMFF ofron shërbime në nivel rajonal dhe lidhet me shërbimet sociale parësore, të cilat menaxhohen nga njësitë e qeverisjes vendore.

Ky shërbim synon njëkohësisht të jetë aktor ndikues në sistemin e parandalimit të institucionalizimit nga njësitë e qeverisjes vendore duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm edhe në zbatimin e moratoriumit të vendosur për të parandaluar hyrjen fëmijëve të rinj në Institucionin e Përkujdesit Shoqëror "Shtëpia e Foshnjës" pranë kësaj bashkie. Strukturat përgjegjëse në nivelin vendor përforcojnë mekanizmin e ndërhyrjes duke ri-orientuar rastet në lidhje me mbështetjen e familjes dhe shërbimeve të kujdesit alternativ sipas legjislacionit aktual në përfitimin nga shporta e shërbimeve në përputhje me nevojat e familjes.

Roli i Ekipit të NISMA ARSIS

Shoqata Nisma ARSIS është partner i Bashkisë Korçë në kuadër të zbatimit të projektit⁵ për ngritjen dhe pilotimin e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen. Ky partneritet është i përcaktuar në detaje në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve nr. 6013 prot, datë 13.07.2021, dhe i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Korçë me nr.37, datë 03.06.2021.

MSHMS ka miratuar projektin e propozuar nga Bashkia Korçë për Ngritjen e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) dhe financimin e tij nëpërmjet Fondit Social buxhetor.

Ekipi i ekspertëve teknikë të deinstitutionalizimit pranë NISMA ARSIS mbështetin:

⁴ Plani Social_Bashkia Korçë

⁵ Ky projekt zbatohet në kuadër të parandalimit të institucionalizimit dhe deinstitutionalizimit dhe është i lidhur me përmbushjen e Prioritetit strategjik nr.2 (objektivi specifik 1) dhe Prioriteti Strategjik nr.3 (objektivi specifik 1) të Planit Social të Bashkisë Korçë.

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare"(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

- ngritjen e shërbimit nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të punonjësve të SHMFF duke i trajnuar, mentoruar dhe supervizuar gjatë punës;
- procesin e ndërgjegjësimit të komunitetit lidhur me shërbimet që ofrohen nga SHMFF;
- procesin e identifikimit të kujdestarëve profesionistë si edhe trajnimin dhe mentorimin e tyre.

Kuadri ligjor

Ngritja e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen me bazë komunitare mbështetet në legjisllacionin në fuqi veçanërisht në:

- Ligjin nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji 139/2015 "Për Vetqeverisjen vendore, funksionimin, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe të organeve përkatëse";
- Plani Social i Bashkisë Korçë;
- Ligjin nr. 18/2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve";
- Vendim nr.866, datë 24.12.2019 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020-2023, dhe planit të veprimit në zbatim të saj";
- VKM nr.518 datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar/rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre në masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar";
- Udhëzim, Nr. 911, datë 27.12.2018 "Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore";
- Vendim nr.706 më datë 09.09.2021 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020– 2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.02.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 20.3.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror";
- VKM nr. 578 dt. 03.10.2018 "Për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimin dhe përgatitjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes";
- Udhëzim nr. 911, datë 27.12.2018 "Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore";
- VKM nr. 659 datë 17.10.2005, "Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore për fëmijët në institucionet e përkujdesit shoqëror";
- Udhëzim Nr.597, datë 22.12.2017 "Për miratimin e Standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqërorë, asistencë shtëpiake për personat me aftësi të kufizuar";
- Urdhër nr. 100, datë 21.2.2020 "Për procedurat standarde të veprimit (psv) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/ punonjësit e shërbimeve të

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare"(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

kujdesit shoqëror, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmave të koordinuar të referimit (mkr).

- Udhëzimi nr.354, dt.02.06.2022 “Për miratimin e standardeve për shërbimin emergjent të sigurt”
- Udhëzimi nr.355, dt.02.06.2022 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të integruar lëvizës në familje, për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre dhe manuali i zbatimit”
- Vendim nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”
- Vendim nr. 136, datë 7.3.2018 “Për funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror”
- Vendim nr. 617, datë 20.10.2021 “Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të Ndhmës Ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre”

Parimet

Parimet e punës për ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen janë në të njëjtën linjë me parimet universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut duke marrë si konsideratë themelore interesin më të lartë të fëmijës. Parimet përforcojnë mënyrën se si funksionojnë dhe sigurohen shërbimet optimale për fëmijët dhe familjet.

a) Parime të Përgjithshme⁶

- *Parimi i universalitetit.* Shërbimet e kujdesit shoqëror janë krijuar, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një sistem rregullash ligjore që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t’u zbatuar në mënyrë të njëjtë për pjesëmarrësit në shërbime që ndodhen në të njëjtat kushte.
- *Parimi i drejtësisë sociale.* Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat, për të cilët ka detyrim ligjor t’i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.
- *Parimi i subsidiaritetit.* Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.
- *Parimi i mbështetjes shoqërore.* Subjektet, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, kanë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

⁶ Neni 4, Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Protokoll i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

- *Parimi i deinstitutionalizimit.* Shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.
- *Parimi i partneritetit.* Funkzionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.
- *Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit.* Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.
- *Parimi i mosdiskriminimit.* Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.
- *Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.* Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Profesionistët e angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ruajnë konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, përfitues të shërbimeve shoqërore⁷, për të cilat kanë marrë dizeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryejnë. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

b) Parime specifike⁸

- *Siguria, qëndrueshmëria dhe zhvillimi i fëmijës është përgjegjësi e të gjithëve.* Identifikimi dhe mbështetja e fëmijëve me nivele të ndryshme rreziku dhe familjeve të tyre, është përgjegjësi e të gjithë shërbim ofruesve dhe komunitetit. Siguria, qëndrueshmëria dhe zhvillimi nuk duhet të shihet si një përgjegjësi vetëm e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Të gjitha strukturat që ofrojnë shërbime për familjet duhet t'i japin prioritet rasteve me rrezikshmëri më të lartë dhe të adresojnë siç duhet nevojat për siguri, qëndrueshmëri dhe zhvillim.
- *Sistemi i ofrimit të shërbimit duhet të ndërhyjë herët që të mbrojë fëmijët dhe të përmirësojë funksionet familjare.* Disa nga familjet nuk kanë aksesuar në kohë shërbimet si rrjedhojë e mosinformimit apo pengesave të tjera. Duhet të jepen informacione të qarta për familjet me nivele rreziku të ndryshme për të identifikuar dhe për të pasur mundësi të aksesojnë shërbimet e përshtatshme. Thënë sa më sipër, shërbim ofruesit që janë në komunitet dhe ofrojnë shërbime për

⁷ Të cilët janë subject i përfitimit nga Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"

⁸ Center for the study of social policy's, (2020), "Strengthening Families - A protective Factor Framework", Washington, DC 2005
Sunraysia Community Health Services., (2020), "The family and child Hub", SCHS, 137 Thirteenth Street (cnr Deakin Avenue) Marrë nga: <https://ëëë.schs.com.au/services/family-child-hub>
Shea. M., (2019), "Becoming a Child and Family Social Worker: A Quick Guide", Noodle. Marrë nga: <https://ëëë.noodle.com/articles/hoë-tobecome-a-child-and-family-social-ëorker>

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare"(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

familjen, duhet të mundësojnë identifikimin e hershëm të familjeve për t'i orientuar që të përfitojnë në kohë shërbimet për të cilat kanë nevojë.

- *Të gjitha shërbimet duhet të drejtojnë fokusin e tyre në nevojat e zhvillimit të fëmijës.* Një fokus i mirëpërcaktuar në nevojat e zhvillimit të fëmijëve do të rrisë përgjegjësinë për të ofruar shërbimin e nevojshëm dhe në kohë për të adresuar nivelin e rrezikut për fëmijën dhe familjen. Kjo do të sjellë identifikimin e hershëm të problematikave dhe riskut (duke përfshirë edhe aktivitetet apo rrethanat e shumëfishta dëmtuese për fëmijën), hartimin dhe zbatimin e planeve vepruese për fëmijën dhe familjen, siguron zhvillimin e fëmijës, dhe gjithashtu do të përmirësojë rezultatet për fëmijën.
- *Shërbimet duhet të fokusohen në ndërtimin dhe ngritjen e kapaciteteve për prindërit, kujdestarët dhe familjet.* Kapaciteti i prindërve, familjeve dhe kujdestarëve për të ofruar mirëritje dhe kujdes efektiv për fëmijët ndikon fuqimisht në jetën e fëmijëve dhe të rinjve. Një qasje e fokusuar në fuqizimin e familjes inkurajon dhe fuqizon familjet që të marrin vetë përgjegjësi për jetët e tyre.
- *Shërbimet për familjen dhe fëmijët duhet të jenë të integruara dhe të koordinuara.* Shërbimi duhet të mbështesë në mënyrë aktive zhvillimin dhe sigurimin e një ndërhyrjeje të integruar dhe të koordinuar në nivel vendor. Familjet do të kenë një strukturë të përbashkët informimi mbi mënyrën e aksesimit të shërbimeve.
- *Shërbimet e ofruara duhet të jenë fleksibël, të dhëna në kohë dhe të orientuara drejt zgjidhjes të problemit me qëllim përmirësimin e funksionimit të familjes.* Shërbimet e orientuara drejt zgjidhjes, fleksibël dhe të dhëna në kohë krijojnë mundësi për një përgjigje më efektive për fëmijën dhe familjen. Kjo mund të drejtojë në përmirësim të funksioneve familjare dhe rezultate më pozitive në kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijës.
- *Shërbimi duhet të ofrojë përgjigje të drejtuara në respektimin e kulturës së familjeve dhe fëmijëve.* Shërbimi kupton dhe i përgjigjet nevojave të veçanta të fëmijëve dhe të familjeve të tyre duke respektuar dhe njohur nevojat e tyre shpirtërore, kulturore dhe sociale dhe duke përshtatur shërbimet sipas këtyre nevojave. Gjithashtu përdoret një gjuhë miqësore dhe e thjeshtë për të kuptuar dhe drejtuar në zgjidhje nevojat e familjes dhe të fëmijëve. Shërbimet e ofruara ofrojnë një qasje pozitive që mundëson zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të përgjithshëm të familjes. Të gjitha këto parime synojnë të orientojnë dhe drejtojnë shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen pranë strukturës së SHMFF.

Profilet e përfituesve

Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen synojnë t'u vijnë në ndihmë fëmijëve dhe familjeve me nevoja të ndryshme me qëllim fuqizimin e tyre. Kryesisht vëmendja i drejtohet familjeve me nevoja të identifikuar, por njëkohësisht po aq rëndësi i kushtohet familjeve të cilat janë në risk dhe do të duhet të

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

ndërhyhet për të parandaluar ndarjen e mundshme të fëmijës nga familja, apo për të fuqizuar fëmijën që ka nevojë për kujdes në kohë, si pasojë e një krize në familje apo pamundësie për tu kujdesur.

Në specifikat që targetojnë përfituesit e shërbimeve pranë SHMFF mund të përmendim:

- familje që kanë fëmijë të vendosur në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë (pavarësisht arsyeve që kanë sjellë ndarjen e fëmijës);
- familje që janë në rrezik për institucionalizimin e fëmijëve të tyre;
- familje me vështirësi të theksuara në ushtrimin e prindërimit që ndikojnë në zhvillimin e fëmijës dhe dinamikave familjare;
- familje me marrëdhënie konfliktuale, duke përfshirë familje të divorcuara, me një prind, kryefamiljare nëna, nëna-vajza, apo në kushtet e një humbje të madhe në familje, etj;
- familje me anëtarë me probleme të shëndetit mendor apo fizik, përdorimit dhe abuzimit me lëndë alkolike/narkotike, aftësisë ndryshe;
- familje kujdestare (profesionale) në nevojë për të përballuar përshtatjen me fëmijën apo menaxhimin e sjelljeve të tij/saj;
- Probleme të theksuara prindërimi që mund të ndikojnë dhe/ose në zhvillimin e fëmijës.

Menaxhimi dhe struktura e shërbimit

Bashkia Korçë ka rolin kryesor në menaxhimin dhe koordinimin e SHMFF. Gjithashtu ajo siguron të gjithë mbështetjen për integrimin e shërbimeve të reja të ngritura në sistemin aktual të shërbimeve shoqërore në nivel qarku dhe bashkie. SHMFF është në varësi dhe menaxhim nga Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social në Bashkinë Korçë.

SHMFF kanë një ekip të përbërë nga 8 punonjës:

- një përgjegjës shërbimi;
- dy punonjës socialë (një punonjës social për të rritur dhe një për fëmijë si dhe në ofrimin e klasave të prindërimit);
- dy psikologë (një psikolog për të rritur dhe një për fëmijë);
- dy kujdestarë (për ofrimin e shërbimit në familje për individët me PAK dhe për familjet e fëmijëve të vendosur pranë IPSH apo në risk institucionalizimi);



- një sanitare.

Struktura e SHMFF është e miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, Bashkia Korçë si dhe përshkrimet e punës së gjithësecilit përfshihen në rregulloren e brendshme të institucionit.

Për më shumë informacion mbi rolin dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të ekipit të SHMFF, referohuni aneksit.nr 1.

Vullnetarizmi dhe Praktikant Profesional pranë SHMFF

Profesionistët e rinj dhe Vullnetarët janë të rëndësishëm për funksionimin e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen po ashtu edhe në rritjen e kapaciteteve të shërbimit ofruesve në nivel lokal, duke marrë role të rëndësishme në përputhje me nevojat e shërbimit dhe realizimit të aktiviteteve për grupet në nevojë. Profesionistët e rinj mund të zhvillojnë praktikant profesional sipas udhëzimeve të Urdhrave profesionalë përkatës si dhe Vullnetarët do të punojnë në përputhje me misionin që ky shërbim ka, duke treguar aftësi të duhura dhe përfshirë në pozicione të lira pune të përshtatura për ta. Procesi i rekrutimit, procedurat dhe përfshirja në aktiviteteve do të jenë në përputhje me Ligjin Nr.45/2016 Për “Vullnetarizmin” si dhe Udhëzimeve të MSHMS për profesionet e lira si psh. Urdhri i Psikologut, Urdhri i Punonjësve Socialë.

- Përshkrimi i pozicionit të rolit të vullnetarit/ praktikantit do të rishikohet në vazhdimësi në bashkëpunim me vullnetarët, ekipin dhe supervisorin.
- Praktikantët/Vullnetarët duhet të njihen dhe firmosin Kodin e Sjelljes dhe Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve.
- Praktikantët/ Vullnetarët duhet të ri-mbursohen për shpenzime të bëra për shkak të rolit të tyre si vullnetarë, përjashtuar shpenzimet e rrugës etj, përveç rasteve të autorizuara nga drejtuesi i institucionit.

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

- Praktikantët/Vullnetarët do të inkurajohen që të japin feedback dhe të jenë pjesmarrës në planifikim, ri-shikim dhe në procesin e vendimmarrjes.
- Praktikantët/Vullnetarët duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që verteton aftësinë e tyre për tu bërë pjese e organizatës, si dëshmi penaliteti, analiza që vërtetojnë gjendjen shëndetësore, dokumenta që vërtetojnë arsimin përkatës, kopje të mjetit të identifikimit, etj.
- Për praktikantët/vullnetarët do të sigurohet një orientim për shërbimet që SHMFF ofron, për të identifikuar nevojat e tyre në rolet që janë të aftë të kryejnë duke ju siguruar edhe trajnimet e nevojshme për të rritur performancën e vullnetarëve.

Mjedisi dhe kushtet fizike ku ofrohen SHMFF

SHMFF zhvillon funksionet e saj në një godinë të Bashkisë Korçë e cila ndodhet në lagjen nr.4, rruga “Bulevardi Fan Noli” Nr.54 Korçë. Mjedisi ku SHMFF ofron shërbimin është lehtësisht i aksesueshëm nga qytetarët. Ndërtesa është dy katëshe dhe ka mjedise të mjaftueshme për të ofruar paketën e plotë të shërbimeve mbështetëse. Një sallë përdoret për të ofruar klasat e prindërimit dhe takimet e ekipit multidisiplinar të SHMFF, një zyrë për takimet me prindër, një zyrë e psikologut ku zhvillohen seancat e këshillimit psikologjik me fëmijët dhe të rriturit, dy mjedise të cilat përdoren për të magazinuar ushqimet dhe një për veshjet dhe mjete higjienosanitare, një oborr i cili është përshtatur në funksion me nevojat e fëmijëve dhe të rriturve për të zhvilluar lojëra dhe aktivitete të ndryshme, si dhe kampin veror për fëmijët.

SHMFF ofron një atmosferë miqësore e cila përfshin:

- Sigurinë që personat që i drejtohen këtij shërbimi mirëpritën menjëherë;
- Ofrimin e një informacioni të disponueshëm (kontakte, orientime drejt shërbimeve të tjera) duke përfshirë edhe kutinë e ankesave në një vend të dukshëm;
- Ofrimin e ndenjësive në ambientin pritës për personat që u duhet të presin;
- Një ambient konfidencial ku përdoruesit ose kërkuesit e shërbimeve të mund të diskutojnë situatën e tyre në mënyrë private dhe të qetë;
- Ofron komunikimin me telefon (SHMFF ka një numër telefoni ku mund të kontaktohet ose të kontaktojnë , i cili është i dedikuar vetëm për SHMFF dhe nuk përdoret asnjëherë numrat personalë të ekipeve) dhe lidhje interneti. Ky lloj komunikimi është shumë i rëndësishëm për të lehtësuar referimet apo ndjekjen e rasteve në koordinim me ndërhyrjen ndërsektoriale, me strukturat e tjera jashtë SHMFF-së.

Mjediset e SHMFF janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimeve dhe me qëllim që anëtarët e ekipit të SHMFF të ushtrorjnë funksionet e tyre në tavolinat e punës, kompjuter të dedikuar, sallë për mbledhje, sallë për takime me fëmijë apo prindër, zyra e këshillimit, mjedise të përshtatshme për të ofruar klasat e prindërimit, etj.

Shërbimet që ofrohen pranë SHMFF


Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

Qëllimi i Shërbimeve për fuqizimin e familjes është të promovojë sigurinë, stabilitetin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve në nivele të ndryshme risku dhe familjeve të tyre si dhe të ndërtojë kapacitete dhe qëndrueshmëri për fëmijët, familjet dhe komunitetet.

Shërbimet e fuqizimit të familjes janë të fokusuara në një ndërthurje të integruar ndërmjet menaxhimit të nevojave për mbrojtje dhe nevojave për kujdes që një fëmijë apo familje paraqet. Shërbimet e fuqizimit të familjes janë orientuar drejt mbështetjes direkte të fëmijës dhe familjes në fazën e parandalimit të ndarjes, ribashkimit me familjen biologjike apo krijimin e kushteve të përshtatshme për një mjedis mbrojtës dhe përkujdesës familjar për çdo fëmijë. Këto shërbime ofrohen në mënyrë të koordinuar me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në Bashkinë Korçë apo dhe bashkitë në nivel rajoni.



Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen janë shërbime të cilat kanë në fokus orientimin e familjes drejt fuqizimit të aftësive për të përmirësuar kujdesin, mbrojtjen dhe rritjen e fëmijës në një mjedis sa më të sigurt familjar.

➤ ***Ofrimi i mbështetjes psiko-sociale përmes informacionit, këshillimit dhe advokimit.***

Familjet e identifikuara nga strukturat përkatëse të cilat referohen për mbështetje psiko-sociale janë pjesë e ndërhyrjeve që SHMFF do të ofrojë. Këshillimi apo shërbimi psiko-social mund të kryhet me fëmijë, të rinj, prindër, kujdestarë ose me të gjithë familjen. Këshillimi familjar gjithashtu është një nga ndërhyrjet e domosdoshme në punën me familjen duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e marrëdhënieve familjare. Kur shërbimet e këshillimit ndeshen me çështje më specifike (siç janë ndërhyrja e specializuar ndaj rasteve të abuzimit seksual ose varësive ndaj drogës dhe alkoolit, problematikave të shëndetit

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

mendor, etj), individi ose familja do t'i referohen shërbimeve të specializuara dhe ky proces do të monitorohet nga punonjësit e SHMFF në bashkëpunim me PMF dhe struktura të tjera të nevojshme për trajtimin e rastit.

➤ **Ofrimi i klasave të prindërimit me qëllim përforcimin e aftësive prindërore**

Ofrimi i klasave të prindërimit për prindërit apo kujdestarët ligjorë të fëmijëve është një shërbim i cili ndihmon familjet të përballojnë periudhat e vështira dhe të rrisin aftësitë e tyre në mirëritjen, edukimin dhe kujdesin tërësor të fëmijëve të tyre. Ndjekja e kurrikulës së prindërimit pozitiv në një cikël të përcaktuar kohor ndërmjet prindërve dhe SHMFF është një nga shërbimet në vijimësi të fokusit mbi ndërhyrjet psiko-sociale. *Për ofrimin e këtij shërbimi, SHMFF përdor manualin dhe udhëzuesin për procedurat e ofrimit të klasave të prindërimit me instrumentat e nevojshëm të cilat janë dokumente që bashkë shoqërojnë protokollin e punës.*

➤ **Sigurimi i aksesit në rrjetet e shërbimeve të tjera në komunitet**

Hartëzimi i shërbimeve në komunitet dhe orientimi i familjeve drejt shërbim-ofruesve në përputhje me nevojat e tyre është një nga shërbimet e tjera që SHMFF ofron në bashkëpunim të ngushtë me Strukturat e Mbrojtjes së Fëmijës, Njësive të Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave apo shërbimeve të tjera sociale brenda dhe jashtë Bashkisë Korçë. Familjet orientohen **drejt** shërbimeve përkatëse të informuar dhe këshilluar nga ana e SHMFF dhe aksesit i tyre mundësohet në vijimësi të bashkëpunimit ndërinstitucional në territorin ku familja ka vendqëndrimin e saj. *Harta e shërbimeve* është dokument që hartohet nga Drejtoria e Kujdesit Social dhe përditësohet nga strukturat e saj.

➤ **Ofrimi i shërbimeve për mbështetje dhe këshillim ligjor/administrativ për familjet**

Procedurat ligjore dhe administrative të cilat lidhen drejtpërdrejt me realizimin e ndërhyrjeve të përshkruara në planin e fuqizimit të familjes, orientohen, mbështeten dhe referohen nga SHMFF drejt shërbimeve të tjera të nevojshme në raste të tilla si divorci, përcaktimi i kujdestarisë së fëmijës, ndjekje e proceseve gjyqësore si dhe informim apo këshillim ligjor mbi çdo procedurë të nevojshme për fëmijën dhe familjen (raste ribashkimi, parandalimi, birësimi apo kujdesi alternativ profesional si dhe për raste të aplikimit të masave të mbrojtjes)

➤ **Ofrimin e mbështetjes me programe për aftësim profesional dhe referim drejt punësimit**

Vlerësimi i thelluar i familjes dhe anëtarëve të saj ndihmon në hartimin e një plani fuqizimi për familjen duke parshikuar edhe aspektin ekonomik. Veprimet me hapat konkretë për fuqizimin ekonomik të familjes ndiqen nga SHMFF në bashkëpunim me struktura të tjera shërbim-ofruese duke nxitur prindërit drejt punësimit. Ofrimi i kurseve profesionale, referimi dhe ndjekja e procedurave pranë Zyrave Vendore të Punësimit, këshillimi për hartimin e një plani biznesi dhe nxitjen e mikroiniciativave janë pjesë e paketës së shërbimeve për aftësim profesional të ofruar nga SHMFF.

➤ **Ofrimi i shërbimeve të specializuara**

Shërbimet e Specializuara për fëmijët, adoleshentët dhe prindërit ofrohen nga profesionistët përkatës kur:

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

- Paraqiten shenja dëmtuese ndaj të tjerëve apo vetdëmtuese deri në mendime/veprime vetvrasëse;
- Vlerësimi nuk mund të realizohet në kushtet e kujdesit parësor, p.sh. Simptoma psikotike, ADHD, etj;
- Nevojitet mjekim dhe trajtim që nuk realizohet në kushtet e kujdesit parësor (çrregullim depresiv tek fëmija, çrregullim i rëndë obsesivo-kompulsiv etj, vështirësi në të folur, në të nxënë, etj);
- Shkalla e paaftësisë është e tillë që personi nuk mund të shkojë në shkollë/kopësht apo të angazhohet në ndërveprime të tjera sociale;
- Shfaqen shenja të neglizhimit ose abuzimit;
- Kanë dështuar përpjekjet e mëparshme të Kujdesit Shëndetsor Parësor për të trajtuar dhe përmirësuar gjendjen e fëmijës/të rriturit.⁹

Krahas simptomave të sipërpërmendura, shërbimi i specializuar për fëmijën dhe familjen orientohet edhe nga SHMFF, punonjësit e së cilës identifikojnë, vlerësojnë llojin e shërbimit të nevojshëm dhe më pas referojnë drejt shërbimeve të specializuara tek profesionistët përkatës. Trajtimi i fëmijës dhe familjes realizohet nga psikologë dhe punonjës socialë të specializuar për trajtimin e çështjeve të fëmijës dhe familjes. Ofrimi i ndihmës së parë psikologjike për rastin ofrohet brenda SHMFF nga psikologë të specializuar të cilët ofrojnë ekspertizën e tyre për trajtimin e çështjeve të ndryshme tek fëmijët dhe të rriturit. ***Shërbimet e specializuara prokurohen nga Bashkia Korçë.***

➤ ***Ofrimi i kujdesit afatshkurtër në shtëpi***

Shërbimet në familje ofrohen për të gjithë fëmijët dhe familjet të cilat janë raportuar nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve (PMF), si raste të vlerësuara për t'u trajtuar me këtë profil shërbimesh. Ekipi i SHMFF së bashku me PMF kryejnë vlerësimin e thelluar të nivelit të rrezikut në të cilin ndodhet fëmija dhe nëpërmjet punonjësve të dedikuar që SHMFF ka për këtë lloj shërbimi, hartojnë një plan ndërhyrje për të gjithë anëtarët e familjes. Qëllimi i shërbimit në familje është që të fuqizojë dhe mbështesë familjen në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e fëmijës në mjedisin familjar. Është e rëndësishme që familja të ketë akses në disa alternativa dhe shërbime mbështetëse në varësi të vendit ku jeton, moshës së fëmijës dhe nevojave të tij. Shërbimet në familje janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen për fëmijët, prindërit, kujdestarët, persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale. Kujdestari i përcaktuar për të ofruar shërbime mbështetëse në familje është aty për të ndihmuar në aktivitete ditore që një familje bën normalisht. Ata mund të qëndrojnë në shtëpinë e familjes ose bëjnë vizita periodike për të monitoruar nëse planifikimi i shërbimeve mbështetëse është përshtatur plotësisht me nevojat e familjes. Ndërhyrjet praktike për ofrimin e kujdesit në shtëpi do t'i përgjigjen çështjeve të identifikuara gjatë periudhës së vlerësimit dhe zhvillimit të Planit të Fuqizimit të Familjes. Disa shembuj mund të jenë:

- *vendosja e rutinave praktike dhe të arritshme;*

⁹ paketa_e_akteve_nën_ligjore_për_shëndetin_mendor_2012

Protokoll i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare"(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

- *këshillim mbi zhvillimin e marrëdhënieve fëmijë-prind dhe prind-prind dhe referim drejt shërbimeve të specializuara kur konsiderohet e nevojshme;*
- *modelimi i aftësive themelore në menaxhimin e nevojave të familjes;*
- *këshillim dhe orientim në blerjen e produkteve/mallrave, përgatitjen e vakteve ushqimore;*
- *mbështetje brenda ambienteve të familjes sipas planit të hartuar (përfshirë edhe rutinën e mëngjesit dhe jashtë orarit zyrtar në darkë, kur vlerësohet me rëndësi për procesin e fuqizimit të familjes).*

Për ofrimin e shërbimit në familje, ekipi i SHMFF bazohet në manualin e ofrimit të shërbimit në familje dhe në udhëzuesin për procedurat e ofrimit të këtij shërbimi, të cilat janë dokumente bashkë shoqëruese të këtij protokollit.

➤ **Identifikim dhe fuqizim i familjeve kujdestare me dhe pa lidhje gjaku**

SHMFF ndihmon në identifikimin, trajtimin dhe hartimin e planit të fuqizimit të familjeve kujdestare me dhe pa lidhje gjaku duke ofruar të gjithë ekspertizën e nevojshme në reduktimin e riskut me të cilin mund të përballlet një fëmijë në mjedisin familjar. Përgatitja e familjeve kujdestare dhe kalimi i hapave konkretë për çdo ndërhyrje të nevojshme do të prioritetizojë nevojat e fëmijës dhe më pas të kujdestarëve të tij. Roli i familjes biologjike do të jetë i rëndësishëm për të qënë pjesë e gjithë procesit të kujdestarisë alternative për fëmijën me qëllim final edhe ribashkimin e tyre. *Për ofrimin e shërbimit në familje kujdestare profesionale, ekipi i SHMFF trajnohet për punën me familjen dhe monitoron procesin bazuar në udhëzuesin për procedurat e monitorimit këtij shërbimi, të cilat janë dokumente bashkë shoqëruese të këtij protokollit.*

➤ **Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për shërbimin e kujdestarisë alternative profesionale dhe mirëqënien e fëmijëve.**

Rritja e ndërgjegjësimit dhe advokimit për çështje të cilat lidhen me shërbimin e kujdestarisë alternative do të jetë në fokus të punës së SHMFF. Adresimi i nevojave të fëmijëve për një jetesë në një mjedis familjar të shëndetshëm dhe të sigurt nuk është përgjegjësi vetëm e strukturave përkatëse por edhe e çdo qytetari i cili kërkon informacion dhe orientim drejt alternativave të reja mbi përkujdesin e fëmijës. Ky proces do të jetë i ndjekur jo vetëm nga SHMFF por edhe me shërbim ofruar të tjerë të cilët në bashkëpunim organizojnë evente të përbashkëta, fushata sensibilizimi, promovimi dhe këshillim të drejtpërdrejtë për çdo kategori të interesuar.

➤ **Shërbim i strehimit të përkohshëm të emergjencës**

Ky shërbim do të ofrohet për fëmijët në rrezik të lartë ose të menjëhershëm. SHMFF do të ketë deri në 2 dhoma emergjence në mënyrë që të ofrojë strehim të sigurt për fëmijët ndaj të cilëve është marrë masë mbrojtëse. Shërbimi i emergjencës do të jetë në dispozicion 24/7. Punonjësit do të jenë në detyrë vetëm kur ka fëmijë të akomoduar. Koha e qëndrimit të fëmijëve në shërbim emergjence është deri në 11 ditë.

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare"(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



Organizimi i punës për ofrimin e shërbimeve

Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen ofrohen gjatë pesë ditëve të javës, nga e hëna deri ditën e premte, me orar zyrtar 8 orë pune në ditë. Përgjegjësi i SHMFF organizon një grafik të ekipit të cilët janë të gatshëm të kontaktohen, të adresojnë nevojat dhe/ose të ofrojnë shërbimet për rastet emergjente përgjatë orareve pas orës 16:00 apo gjatë ditëve të pushimit ose festave zyrtare.

Shërbimet që ofron SHMFF janë të mirë përcaktuara përsa i përket numrit të përfituesëve, kohës së ofrimit të tyre dhe shtrirjes gjeografike sipas rasteve të identifikuar. Nëse ndodh që ekipi i shërbimeve mbështetëse të përballet me një situatë emergjente jashtë orareve zyrtare të punës, linja e komunikimit, referimit apo ofrimit të shërbimit, mënyra e funksionimit është e qartë dhe e njohur nga çdo strukturë bashkëpunuese. Përgjegjësi i shërbimit njoftohet për rastin emergjent dhe bën referimin pranë strukturës përkatëse.

Përgjegjësi i shërbimit kujdeset që në përbërje të ekipit të gatshëm të jetë një punonjës social dhe një psikolog ose njëri prej tyre i koordinuar me ekipin kujdestar. Ky grafik hartohet mbi bazë javore ose mujore. Për angazhimin e ekipit pas orarit zyrtar, bëhet trajtimi i tyre në bazë të Kodit të Punës për orët shtesë.

***Në vëmendje:** Koordinimi i ekipit pas orarit të punës lidhet me përgjigjen apo reagimin e SHMFF vetëm për rastet në nevojë imediate (*Në rastet e rrezikut të ulët ose të mesëm këshillohen familjarët për të lehtësuar situatën emergjente nëpërmjet ndihmës së parë psikologjike apo ndërhyrjen direkte deri sa ekipi me profesionistët përkatës të marrin rastin në trajtim gjatë orëve në vijim*).

***Në vëmendje:** Për rastet të cilat referohen, identifikohen nga strukturat në nevojë për shërbim dhe strehim në emergjencë (*Rasti i identifikuar pasi kalon në një vlerësim fillestar nga PMF vendoset përkohësisht në shërbime emergjente vetëm kur rreziku është i lartë ose emergjent*) SHMFF-ja organizon punën me një ekip të dedikuar për shërbimin e emergjencës i cili kërkon përkujdesje 24 orë në 7 ditë të javës. Shërbimi i emergjencës ofrohet nga 72 orë deri në 11 ditë, afat ky që mund të përshtatet me specifikat e rastit. Për procedurat e SHMFF në lidhje me shërbimin e emergjencës, jepet informacion i mëtejshëm në aneksin përkatës por njëkohësisht SHMFF i referohet udhëzimit nr.354, dt.02.06.2022 për standardet e shërbimit të strehimit të sigurt.

SHMFF vendos në dipozicion të ekipit dhe të përfituesve një numër telefoni.

Grafiku i ekipit për situata emergjente							
	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel



BASHKIA KORÇË

Orari zyrtar	8-16.00 Ekipi i SHMFF	8-16.00 Ekipi i SHMFF	8-16.00 Ekipi i SHMFF	8-16.00 Ekipi i SHMFF	8-16.00 Ekipi i SHMFF	Punonjës social/Psikolog/ kujdestar	Punonjës social/Psikolog/ kujdestar
Pas orarit zyrtar	Punonjës social/Psikolog/ kujdestar	Punonjës social/Psikolog/ kujdestar	Punonjës social/Psikolog/ kujdestar	Punonjës social/Psikolog/ kujdestar	Punonjës social/Psikolog/ kujdestar		

Metodologjia e ofrimit të shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen

Roli kryesor funksional i SHMFF-së është të ofrojë shërbime, nëpërmjet qasjes së menaxhimit të rastit, metodologji pune si një seri veprimesh/procedurash që janë krijuar për të siguruar që të gjitha rastet (përfshirë dhe rastet e abuzimit) të trajtohen, administrohen në kohë dhe me cilësi duke përbushur nevojat e përfituesve. Duke qenë se fokusi i punës së SHMFF është familja me në qendër fëmijën, metodologjia e ndjekur në menaxhimin e rastit në këtë strukturë, është në të njëjtën linjë me procesin e menaxhimit të rastit që ndiqet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve¹⁰ dhe qendrat komunitare.

Hapi 1_ Identifikimi, regjistrimi dhe pranimi në shërbim

Identifikimi i rasteve të përfituesve në nevojë për mbështetje realizohet nëpërmjet:

- *Identifikimit proaktiv nga vetë punonjësit e SHMFF-së:*
 - gjatë punës në terren
 - gjatë aktiviteteve ndërgjegjësuere
 - gjatë veprimtarive të ndryshme
- *Referime nga agjensitë/strukturat e tjera publike dhe jopublike për raste në nevojë për shërbimet e SHMFF-së:*
 - NJVNR në Bashki ose NJA (administrator shoqëror ose punonjësi me detyrë të deleguar atje ku ende nuk është ngritur NJVNR);
 - PMF/NJMF;
 - Administratorë shoqërorë;
 - Ndërlidhësit e komunitetit (kryepleq);
 - Shërbimi psikosocial në institucionet arsimore/çerdhe/kopshte/shkolla përfshirë dhe komisionet multidisiplinare për PAK në ZVA;
 - Shërbimi psikosocial në institucionet shëndetësore/konsultore/ qendra shëndetësore/spitale/ maternitete;
 - Strukturat vendore të policisë/prokurorisë/gjykatës;
 - Institucione të përkujdesit shoqëror për fëmijë apo të rritur përfshirë dhe qendrat e zhvillimit;

¹⁰ Referencë të Ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe VKM nr.578/2018 që përcakton hapat e menaxhimit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje.

Protokoll i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

- Përfaqësues të institucioneve të ndryshme që vlerësojnë nevojën për ndihmë të një përfituesi;
- Grupi Teknik Ndërsektorial (rastet e fëmijëve të marrë në mbrojtje ose në rrezik për tu marrë në mbrojtje);
- Ekipi Teknik Ndërsektorial (rastet e dhunës me bazë gjinore).

➤ *Vetëreferim nga qytetarët/et që shkojnë pranë SHMFF-së ose referime nga komuniteti*

Ekipi i SHMFF njofton në mënyrë periodike Drejtorinë e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale në Bashki për rastet e familjeve që marrin shërbim pranë tyre. Vlen të theksohet se shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen nuk zëvendësojnë funksionet e përcaktuara në legjislacionin aktual të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve apo njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit. Shërbimet e ofruara nga profesionistët, plotësojnë, asistojnë dhe mbështesin ndërhyrjet e nevojshme të rastit në të gjithë procesin e udhëhequr nga strukturat e NJMF apo NJVNR.

Në vëmendje të ekipit të SHMFF:

Identifikimet /Referimet mund të kryhen:

- në mënyrë të drejtpërdrejtë
- me telefon (emergjencë)
- me email (emergjencë)
- me shkresë zyrtare/formë referimi
- nëpërmjet medias së shkruar apo vizive

Në të gjitha situatat, ekipi i SHMFF-së ka për detyrë të dokumentojë procesin nëpërmjet printimit të emailit, publikimit apo protokollimit të shkresës zyrtare duke rregjistruar çdo identifikim apo referim në përputhje me respektimin e konfidencialitetit të çdo individi.

Instrumenti i përdorur për të dokumentuar mënyrën e identifikimit është bashkëngjitur këtij protokollit në aneksin nr.xx , formulari yy dhe synon të pasqyrojë të dhënat bazë të fëmijës/familjes; arsyet e shqetësimit të referuar; vendin; koha, ora dhe personi apo struktura që e ka identifikuar dhe apo referuar.

Kush e plotëson: Ky formular plotësohet kryesisht nga punonjësit socialë apo psikologë por në varësi të procesit të identifikimit mund të plotësohet nga çdo punonjës që vendoset në kontakt për herë të parë me historikun apo vetë fëmijën apo familjen.

Hapi 2_Vlerësimi

Vlerësimi përfshin mbledhjen dhe analizimin e informacionit për kërkuesin e shërbimit apo personin e referuar për të kuptuar cilat janë nevojat dhe çfarë veprimesh konkrete duhen ndjekur në vijim për plotësimin e nevojave dhe përmirësimin e situatës. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi të bazohet në nevoja e identifikuar të fëmijës dhe individit të rritur në familje dhe jo të bazohet vetëm në shërbimet e mundshme që disponohen.

Protokoll i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

Vlerësimi si një **proces** kalon nëpër një sërë fazash, të cilat përmbledhen si më poshtë:

1. *Përgatitja për vlerësim*
 - a. koha
 - b. cilët janë partnerët që do të përfshihen
 - c. format që do të përdoret
2. *Ngritja e hipotezave*
 - a. Merr në konsideratë të gjitha mundësitë
 - b. Parashikon skenarë të mundshëm
 - c. Ngre supozime
3. *Mbledhja e informacionit (instrumentat që përdoren për mbledhjen e infos)*(shih Shtojcën) a.*

Forma e vizitës në familje

 - b. Intervistë e strukturuar, gjysëm e strukturuar
 - c. Genograma
 - d. Ekoharta
 - e. Instrumente specifike sipas profileve të profesionistëve
4. *Teston informacionin*
 - a. Verifikon infon nga disa burime
 - b. Teston dhe qartëson infon
 - c. rishikon
5. *Analizon dhe kupton informacionin e mbledhur;*
6. *Planifikon veprimet për ndërhyrje bazuar në këtë analizë.*

E rëndësishme që gjatë procesit të vlerësimit punonjësi duhet:

- *të sigurojë evidenca të mjaftueshme të nevojave të paplotësuara, dëmit/dhunës apo abuzimit*
- *të marrë në konsideratë faktet/ngjarjet e kaluara*
- *të mos harrohet edhe nevoja që të ndërmerren veprime të menjëhershme*
- *të sigurojë bashkëpunimin dhe përqasjen e përbashkët ndërsektoriale në këtë proces, për të vlerësuar të gjitha nevojat e fëmijës dhe anëtarëve të familjeve bazuar dhe në ekspertizën institucionale*
- *të ketë empati dhe mirëkuptim të ndjenjave, mendimeve të fëmijës dhe të çdo anëtar të familjes*
- *të kujdeset që cilësia e marrëdhënieve mes punonjësve socialë dhe prindërve/kujdestarëve, ndikon në përmbajtjen dhe plotësinë e informacionit të mbledhur gjatë procesit të vlerësimit*

Llojet e vlerësimit

Vlerësimi fillestar është vlerësimi i shpejtë, bazuar në informacionin që disponohet nga identifikimi proaktiv, referimi apo raportimi si dhe nga informacionet që mund të mblidhen nga palë të treta, si institucione, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

fëmijën dhe familjen. Ky vlerësim kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve dhe, maksimalisht, brenda 48 orëve pas identifikimit /referimit .

Vlerësimin e kryen ekipi i SHMFF-së, kryesisht punonjësi social, i/e cili/cila vlerëson:

- a. Çdo nevojë bazë të ngutshme të anëtarëve të familjes që duhet të trajtohet si një çështje emergjente (ushqimit, higjienës, strehimit dhe kujdesit shëndetësor)
- b. Nëse fëmijët në familje janë të sigurtë *(për një periudhë afatshkurtër, duke mbajtur në konsideratë sigurinë, mbrojtjen fizike, shëndetin e fëmijës dhe nevojën për masë emergjente të mbrojtjes)*

***Në vëmendje:**

Nëse fëmija apo anëtar i familjes është në rrezik apo ka nevoja bazë të ngutshme, punonjësit ndërhyjnë paralelisht me shërbime dhe veprimet për të plotësuar këto nevoja dhe njëkohësisht vijohet me procesin e vlerësimit. Gjithmonë duhet të mbahet në konsideratë që plotësimi i nevojave emergjente janë primare mbi cdo procedurë tjetër.

Në rastet kur gjatë procesit të vlerësimit, ekipi i SHMFF-së identifikon tregues të rrezikut të lartë ndaj të cilëve është i ekspozuar fëmija, ka detyrim të raportojë menjëherë pranë strukturave të mbrojtjes së fëmijës (në vëmendje neni 67 _Ligji 18 Për të drejtat e dhe mbrojtjen e fëmijës). E njëjta procedurë duhet të respektohet edhe për anëtarët e rritur të familjes të cilët mund të ndodhen në kushtet e rrezikut të lartë apo në nevojë për ndërhyrje emergjente, si.psh në rastet e dhunës në familje, raportohet menjëherë tek specialisti që trajton çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Vlerësimi i thelluar ose i plotë është një proces që realizohet në një kohë më të zgjatur, e cila rekomandohet të kryhet deri në 20 ditë pune. Në procesin e vlerësimit të thelluar përfshihen edhe profesionistë të tjerë të SHMFF-së. Në kushtet kur situata në familje paraqitet në nivel të lartë rreziku apo kompleksitet problematikash, procesi i vlerësimit të thelluar duhet të kryhet brenda një afati kohor më të shkurtër i cili nuk duhet ti kalojë 7 ditë.

Në një rast mund të jetë e nevojshme që të ndërmerren **vlerësime specifike të specializuara** nga profesionistë të fushës kur fëmija ka nevoja të veçanta shëndetësore apo aftësi të kufizuara ose mund të jetë përdorues i lëndëve narkotike apo i diagnostikuar me HIV Aids . P.sh. një fëmijë me nevoja të veçanta të të folurit mund të ketë nevojë për një vlerësim nga ana e logopedistit, psikolog zhvillimi; nëse ka probleme të shëndetit mendor, mund të jetë e nevojshme përfshirja dhe vlerësimi nga ana e një psikiatri/psikologu, që është i specializuar për këto probleme: nëse është përdorues i lëndëve narkotike ka nevojë për vlerësim mjek toksikolog, etj. Kjo do të thotë, që në këtë rast, procesi i vlerësimit kthehet në një proces “më kompleks për t’u koordinuar dhe menaxhuar” pasi vlerësimet e specializuara furnizojnë procesin me informacione të detajuara që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në planin e ndërhyrjes dhe masave të marra.

***Në vëmendje:**

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

- Rastet e referuara pranë SHMFF-së nga institucionet e përmendura më sipër (nuk përfshihen rastet e referuara nga qytetarët) duhet të jenë të shoqëruara me vlerësim fillestar. SHMFF vijon me procesin e vlerësimit të thelluar.
- Për çdo anëtar të familjes kryhet procesi i vlerësimit sipas nevojave dhe problematikave individuale.

Instrumentët e përdorur:

- Për vlerësimin fillestar plotësohet instrumenti i vlerësimit fillestar (i përshtatur nga anekset e VKM nr.578)
- Për vlerësimin e plotë plotësohet instrumenti i vlerësimit të plotë (i përshtatur nga anekset e VKM nr.578), i cili përfshin
 - *historikun të familjes;*
 - *statusin ligjor të anëtarëve madhorë të familjes;*
 - *marrëdhëniet e prindit me fëmijët*
 - *marrëdhëniet familjare në çift;*
 - *marrëdhëniet e familjes dhe pjesëtarë të tjerë në familjes me komunitetin;*
 - *faktorët e rrezikut që ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës dhe ndryshimet që duhen bërë;*
 - *identifikimin i nevojave shëndetësore psikologjike, emocionale, edukative, zhvillimore, besimit, financiare që duhen përmbushur;*
 - *pikat e forta të familjes dhe qëndrueshmëria;*
 - *perceptimin i anëtarëve të familjes lidhur me situatën në të cilën ndodhen;*
 - *nivelin e gatishmërisë/aftësisë së familjes për ndryshime;*
 - *aftësinë e familjes për t'u kujdesur për fëmijën për të ofruar kujdes bazë, siguri, qëndrueshmëri;*
 - *situatën ekonomike e familjes (identifikimi i kushteve fizike të banesës, të ardhurat etj);*
 - *identifikimin e shërbimeve që familja ka përfituar nga strukturat vendore.*
- Për vlerësimin e specializuar plotësohet instrumenti që është specifik sipas specialitetit, p.sh mjeku psikiatër, mjek pediatër zhvillimi, mjek psikopediatër, mjek fiziatër, psikologu i zhvillimit, të parashikuar në protokollet e tyre të punës etj.
- Për vizitën në familje plotësohet forma e vizitës dhe vëzhgimit në familje.
- Për intervistimin plotësohet forma e intervistës së strukturuar ose gjysmë të strukturuar.
- Në rast të përdorimit të instrumentave të ndryshëm për mbledhjen e të dhënave, plotësohet forma përkatëse.

Kush e plotëson: Forma e vlerësimit fillestar apo të plotë plotësohen nga ekipi i SHMFF, punonjësit e rastit, që mund të jenë punonjësi social apo psikologu, por pjesë e ekipit vlerësues janë dhe anëtarët e tjerë të ekipit sipas profileve të tyre. Ndarja e rasteve kryhet në mbledhjen e grupit multidisiplinar të SHMFF-së dhe koordinohet nga përgjegjësi i shërbimit. Vlerësimet e specializuara kryhen dhe plotësohen vetëm nga specialisti përkatës.

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



Hapi 3_Planifikimi

Pas shqyrtimit të informacionit të hollësishëm rreth fëmijës dhe familjes nga Ekipi i SHMMF-së dhe të gjithë aktorët/ institucionit e përfshira në procesin e vlerësimit dhe mbështetjes me fokus:

- Nevojat e identifikuar për secilin pjesëtar të familjes;
- Shërbimet emergjente për fëmijën dhe familjen;
- Shërbimet e nevojshme për fëmijën dhe familjen;
- Institucione të përfshira dhe në kontakt me fëmijën dhe familjen.

Vijohet me hartimi i planit të fuqizimit. Pjesë e këtij procesi bëhet dhe fëmija dhe familja. Plani i fuqizimit përmban në strukturë të tij:

- Nevojat e identifikuar;
- Objektivat që synohen të arrihen
- Aktivitetet apo veprimet që duhet të ndërmerren për të arritur objektivin;
- Koha kur duhet të kryhet aktiviteti;
- Ekipi/personel/struktura përgjegjëse që duhet të kryejë këtë veprim/aktivitet;
- Kostot e parashikuara për të kryer çdo veprim;
- Treguesit e realizimit të çdo aktiviteti;
- Nevoja për monitorim dhe rishqyrtim.

Plani i fuqizimit synon të arrijë:

- i. Përmirësimin e kushteve të rishoqërimit të familjes;
- ii. Përmirësimin e kushteve ekonomike të familjes;
- iii. Përmirësimin e dinamikave brenda familjes; iv. Ngritja e kapaciteteve prindërore;
- v. Asistim dhe mbështetje e fëmijës dhe familjes në hapat e përcaktuar;
- vi. Vendosi dhe ruajtja e komunikimit të vazhdueshëm me familjen;
- vii. Plan Individual Psikologjik (këshillim/terapi/mbështetje);
- viii. Referim drejt Institucioneve të tjera për shërbime të specializuara;
- ix. Shërbime emergjente në rast nevoje;

Plani dakordësohet ndërmjet aktorëve të përfshirë ku një rol shumë të rëndësishëm ka përfshirja dhe dakordësimi me familjen përfituese të shërbimit dhe palët nënshkruajnë një dokument marrëveshjeje lidhur me shërbimet që do të ofrohen dhe të drejtat e detyrimet e secilës palë.

Plani i fuqizimit të familjes hartohet sapo përfundon procesi i vlerësimit të plotë. Në planin e hartuar përfshihen dhe veprimet që janë ndërmarrë në kushtet e emergjencës (nëse janë ndërmarrë) gjatë kryerjes së vlerësimit të thelluar apo të plotë. Plani hartohet në mënyrë të tillë që të përfshijë veprime të qarta, të thjeshta, të prekshme dhe të realizueshme dhe në terma kohorë që sigurojnë ndikim dhe efekt përmirësimi në jetën e anëtarëve të familjes.

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

Instrumenti: Plani i fuqizimit hartohet dhe plotësohet sipas formatit bashkëngjitur tek anekset.

Kush e plotëson: Plani i fuqizimit hartohet në bashkëpunim me të gjithë aktorët, nënshkruhet prej tyre dhe dokumentohet nga punonjësi i rastit.

Hapi 4_Zbatimi dhe Ndjekja e Planit

Pas hartimit të planit, zbatimi dhe ndjekja e tij janë dy procese po aq të rëndësishme, të cilat mundësohen nëpërmjet ofrimit të shërbimeve konkrete si dhe përmes orientimeve apo referimeve drejt strukturave të tjera shërbimofruese. Gjatë kësaj fazë, punonjësit e rastit duhet të ndjekin rregullisht ecurinë e familjes dhe të vetë procesit për të garantuar se plani po zbatohet.

Në rast se punonjësi identifikon problematika në zbatimin e planit, të cilat kanë ndikim në cilësinë e ofrimit të shërbimeve atëherë njofton përgjegjësin e SHMFF dhe kërkohet thirrja e takimit të EMD.

Instrumenti: Ndjekja dhe zbatimi i planit monitorohet në të njëjtin format të planit të fuqizimit në kolonën e parashikuar për monitorimin.

Kush e plotëson: Ky proces ndiqet dhe dokumentohet nga punonjësi i rastit sipas rishqyrtimit në grupin e EMD dhe të GTN/ETN sipas kategorisë.

Hapi 5_Rishikimi i Planit dhe ecurisë

Planet duhet të rishikohen në mënyrë të rregullt për të siguruar se planifikimi i realizuar përmbush nevojat e fëmijës dhe familjes dhe procesi është në rrugën e duhur. Koha për rishikimin periodik të planit të fuqizimit vendoset nga vetë anëtarët e EMD dhe partnerët e tjerë të përfshirë në takimin e parë kur është marrë vendimarrja për hartimin e planit. Kjo varet nga:

- kompleksiteti i problematikave të familjes
- niveli i përfshirjes dhe bashkëpunimit të familjes në procesin e ndihmës - dinamikave në proces

**Rekomandohet që planet të rishihen një herë në tre muaj.*

Instrumenti: Format i rishikimit të planit është i njëjtë me formatin e planit të fuqizimit të familjes, por ekipi duhet të kujdeset që të dokumentojë datën e rishikimit dhe përditësimin e të gjithë aktiviteteve të realizuara si dhe aktivitetet e reja të parashikuara. Ekipi kujdeset që çdo plan i realizuar dhe rishikuar të dokumentohet në dosjen e familjes.

Kush e plotëson: Plotësimi dhe dokumentimi i rishikimit të planit kryhet nga punonjësit e rastit, të cilët kujdesen që të pasqyrojnë edhe mendimet e padakordësuara të anëtarve të EMD –së.

Hapi 6_Mbyllja e rastit

Procesi i mbështetjes do të mbyllet kur zbatimi i planit ka funksionuar në arritjen e objektivave të përcaktuar dhe janë përmbushur nevojat e fëmijës dhe familjes nëpërmjet shërbimeve të SHMFF apo duke

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare"(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

i adresuar drejt shërbim ofruesve të tjerë sipas specifikave. Në këtë fazë të procesit përgatitet nga Ekipi i SHMFF një plan dalje në bashkëpunim me Fëmijën dhe Familjen, sesi familja do të kalojë nga shërbimet mbështetëse në përfundim të tyre. Këto hapa mund të përmbajnë:

- Referim drejt shërbimeve të tjera alternative që do të sigurojnë ofrimin e shërbimit dhe qëndrueshmërinë e arritjeve të deritanishme të fëmijës dhe familjes;
- Ekipi i SHMFF dhe përgjegjësi do të sigurohen që të gjithë objektivat e përcaktuar janë arritur;
- Vlerësim i risqeve të mundshme për një rikthim të situatave vulnerabël do të bëhet përpara se ky proces të mbyllet;
- Treguesi më i përshtatshëm se kur ky rast të mbyllet është kur niveli i riskut të jetë i ulët ose i mesëm.

Arsyet për mbylljen e rastit përfshijnë:

- kur të gjithë fëmijët e familjes kanë mbushur moshën 18 vjeç;
- kur nuk ka arsye të mëtejshme rreziku për fëmijën dhe familjen;
- kur familja ndryshon vendbanim;
- kur familja refuzon të marrë shërbim;
- kur familja nuk frekuenton SHMFF të paktën 6 muaj.

Vendimarrja për mbylljen e rastit merret e përbashkët me të gjithë pjesëmarrësit e hartimit të planit të fuqizimit të familjes. Në rastet ku punonjësi i përfshirë në procesin e mbështetjes ka një mendim të ndryshëm nga ai i mbylljes së procesi të mbështetjes, ai duhet ndarë dhe dokumentuar.

Instrumenti: Formulari për mbylljen e rastit është i përfshirë tek anekset. Ky formular dokumentohet dhe ruhet në dosjen e përfituesit të shërbimit

Kush e plotëson: Formulari i mbylljes së rastit plotësohet nga punonjësi i rastit

Dokumentimi i procesit të ofrimit të shërbimeve

Gjithë protokollin e punës së ofrimit të shërbimeve për çdo fëmijë apo përfitues të rritur është i shoqëruar në një paketë instrumentash, të bazuara në legjislacionin përkatës për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, të cilat dokumentohen nga ekipi përgjegjës. Ky dokumentacion vendoset në dosjen individuale të çdo fëmije apo përfituesi të rritur e cila mbahet në mënyrë shkresore dhe elektronike dhe përmban:

- 1- Formularin e identifikimit
- 2- Formularin e vlerësimit fillestar
- 3- Formularin e vlerësimit të thelluar
- 4- Plani i ndërhyrjes për fuqizimin e familjes
- 5- Planin e individual të mbrojtjes nëse është nevoja
- 6- Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet familjes dhe SHMFF
- 7- Miratimin e informuar ndërmjet përfituesit dhe profesionistit

Protokollin e punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

8- Instrumenta specifike sipas shërbimeve të specializuara

Lista e dokumentave mund të pasurohet dhe përmirësohet bazuar në eksperiencën dhe praktikën e punës. Çdo fëmijë apo përfitues i rritur ka kodin e vet dhe të dhënat e gjithësecilit pasqyrohen edhe në një **databazë elektronike** e cila përmban përveç të dhënave identifikuese të çdo rasti edhe kohën e përfshirjes në program, kategorinë e problemit, strukturën që e ka referuar, shërbimet që ka marrë në SHMFF, agjensitë bashkëpunuese, ku do të referohet, të dhëna të segreguara si meshkuj-femra, aftësi e kufizuar, të dhëna për kujdestarët ligjorë, venbanimin apo vendqëndrimin, etj. Databaza kujdeset që të gjenerojë të dhëna sasiore dhe informacion që të ndihmojë SHMFF-në dhe Bashkinë Korçë të analizojë dhe të parashikojë ndërhyrje në funksion të përmirësimit dhe plotësimit të nevojave të çdo përfituesi si dhe parashikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm.

Hartëzimi i shërbimeve

SHMFF njëkohësisht duhet të jetë e informuar në kohë dhe të krijojë hartën e shërbimeve për shërbimofruesit publikë dhe jopublikë në njësinë apo territorin ku ajo kryen aktivitetin e saj, ku përfshihen qendrat shëndetësore, spitalet, klinikat e specializuara, qendra komunitare e shëndetit mendor, institucionet e arsimit parashkollor dhe parauniversitar, shërbimi psikosocial në shkolla, komisaritet e policisë, punonjësit e policimit në komunitet, ndërlidhësit komunitarë, administratorët socialë, etj si dhe organizatat jofitimprurëse. Ky hartëzim është shumë ndihmues dhe plotësues në koordinim shërbimesh, plotësimin e nevojave dhe planifikim ndërhyrjesh efikase për çdo rast që merr pjesë në programet e SHMFF-së.

Për çdo institucion duhet të mbahet informacion mbi kontaktin e personave përgjegjës, vendodhjen, llojin e shërbimeve, kohëzgjatjen e tij dhe kategorinë e përfituesve. SHMFF vendos marrëdhënie me të gjitha strukturat e nevojshme duke dakortësuar mënyrën e bashkëpunimit në marrëveshje të veçanta me secilën. Marrëveshjet njihen dhe miratohen nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Korçë.

Kodi i etikës dhe konfidencialiteti

SHMFF është pjesë e shërbimeve shoqërore që ofron Bashkia Korçë për komunitetin e saj. Kodi i etikës dhe parimi i konfidencialitetit respektohen në baze të protokollit të miratuar për shërbimet e kësaj qendre si dhe rregullores për funksionimin e shërbimit. SHMFF ndjek dhe zbaton të gjitha rregullat për sa i përket konfidencialitetit të përfituesve që përfitojnë shërbime pranë saj, për shkak të problematikave dhe vulnerabilitetit. Rekomandohet që ekipi të tregohet korrekt dhe sa më profesionist në punë e tij dhe të mos ndajë asnjëherë numra telefoni/rrjete sociale apo kontakte personale me fëmijët apo personat e rritur përfitues të shërbimeve apo të ndajnë detaje nga jeta e tyre personale. Të gjitha hapat dhe veprimet që duhet të kenë në vëmendje anëtarët e stafit për të ofruar një shërbim korrekt dhe cilësor në lidhje me marrëdhëniet me njëri-tjetrin dhe marrëdhëniet me përfituesit fëmijë apo të rritur parashikohen **në Dokumentin e Politikave të Mbrojtjes së SHMFF, Kodit të Etikës dhe miratimit të informuar, të cilat bashkëshoqërojnë Protokollin e Punës së SHMFF.**

Protokollin i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



Mënyrat/procedurat e marrjes së shërbimeve të specializuara

Ekipi i specialistëve mbështetës që përbëhet nga psikologë terapistë, mësues mbështetës, logopedë, fizioterapistë dhe profesionistë të tjerë (të jashtëm) do të mbështesin punën e ekipit të SHMFF-së duke ofruar trajtim psikologjik, mbështetje psikosociale, trajnime të strukturuar dhe mbështetje të përbashkët për fëmijët, familjet dhe kujdestarët e përfshirë në shërbime të ndryshme.

Identifikimi i nevojës për vlerësim dhe ndërhyrje të specializuar realizohet nga ekipi multidisiplinar i SHMFF dhe/ose PMF/NJVNR apo profesionistë të tjerë.

Ofrimi i shërbimeve të specializuara prokurohet nga Bashkia Korçë, në përputhje me legjislacionin përkatës për prokurimet e shërbimeve shoqërore¹¹, bazuar dhe në termat e referencës për shërbimet e specializuara (*dokument bashkëshoqërues i këtij protokollit*).

Instrumentet: Çdo profesionist i kontraktuar për të ofruar shërbimin e specializuar, ndjek procedurat sipas protokollit përkatës të cilat bëhen pjesë e dosjes së emnaxhimit të rastit nga ekipi multidisiplinar.

Kush e plotëson: Formularët dokumentohen prej specialistëve të kontraktuar nga SHMFF.

Mënyrat /procedurat për marrjen e shërbimit të kujdesit në shtëpi (domiciliary services)

Modeli i “shërbimit në familje”, është një model i ndërtuar për të qenë sa më pranë familjeve, vlerësimi i nevojave së bashku me anëtarët e familjes, fleksibiliteti, mbështetja dhe fuqizimi për të zgjidhur problemet dhe fokusi tek përforsimi i pikave të forta të familjes janë element, të cilët duhen marrë në konsideratë gjatë ofrimit të shërbimit. Kujdesi në shtëpi konsideron dhënien e disa shërbimeve bazë për familjen, shërbime kryesorë të vlerësuara si të nevojshme për kontekstin e familjeve në vështirësi, në mungesë të potencialit prindëror për kujdesin, mbrojtjen dhe mirërritjen e fëmijëve.

Është e rëndësishme të theksojmë, që shumë shërbime të tjera në mbështetje të familjes, të cilat mund të ofrohen në ambientin e tyre natyral dhe janë në përmbushje të nevojave të këtyre familjeve mund të ofrohen dhe në këtë mënyrë plotësohet qëllimi kryesor i këtij shërbimi, që lidhet pikërisht me fuqizimin e familjes për mbrojtje dhe mirërritjen e fëmijëve në një ambient të sigurt.

Baza e funksionimit të këtij shërbimi do të jetë qasja mbi menaxhimin e rastit, si një mënyrë për garantimin e cilësisë dhe aksesit në shërbime. “Shërbimi i Kujdesit në familje”, si një shërbim i targetuar është një ndër format që Plani i Mbrojtjes dhe Përkujdesit i hartuar për fuqizimin e familjes propozon të realizohet brenda strukturës natyrale (shtëpisë) në të cilën familja jeton. Dhënia e shërbimit koordinohet nga një ekip multidisiplinar i vendosur pranë SHMFF, i cili merr përsipër të ofrojë këtë shërbim bazuar në referencat nga PMF/NJVNR apo aktorë të tjerë. SHMFF ka në si pjesë të saj staf të dedikuar për ofrimin e

¹¹ Vendim nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”

Protokoll i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

shërbimit në familje, i cili është pjesë e EMD dhe ofron shërbimin bazuar në manualin përkatës dhe ndjek udhëzuesin e procedurave për shërbimin në familje dhe instrumentat përkatës. **Hapat e punës në ofrimin e kujdesit në familje**

Hapi i parë - Vendosja e marrëdhënies së besimit. Ofruesi i ndihmës së pari punon ngushtësisht me familjen për të arritur nivelin e besueshmërisë, krijon mundësi për të vendosur komunikim efektiv me anëtarët e familjes dhe tregohet pranues ndaj kulturës dhe vlerave të familjes.

Hapi i dytë - Vlerësimi i thelluar i nevojave të familjes në mjedisin e shtëpisë, të cilat përditësohen në fletën e ditarit dhe pasqyrohen në aktivitetet e planit të ndërhyrjes.

Hapi i tretë - Përcaktimi i prioriteteve, vendosja e objektivave afatshkurtër së bashku me familjen dhe zhvillimi i një plani me bazë ditore për ndërhyrjen.

Hapi i katërt - Zbatimi i planit të fuqizimit të familjes, i cili në bazë të ecurisë kërkon ri-organizim që përcaktohen në bashkëpunim me familjen.

Hapi i pestë - Vlerësimi i ndërhyrjes në tërësi dhe raportimi mbi rezultate e arritura nga ana e ofruesit të ndihmës dhe familjes

Hapi i fundit - Mbyllja e marrëdhënies mbështetëse/të ndihmës.

Instrumentet: Fleta e ditarit, formulari i raportimit javor, raporti përmbledhës për ofrimin e shërbimit, plani javor aktivitetesh, plani i punës, marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet familjes dhe SHMFF

Kush e plotëson: Formularët dokumentohen prej punonjësit që ofron shërbimin në familje. Marrëveshja e bashkëpunimit nënshkruhet nga familja dhe kordinatori i SHMFF

Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit shërben për të siguruar cilësinë dhe impaktin e një shërbimi për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre nëpërmjet mbledhjes së të dhënave dhe matjes së progresit të objektivave të përcaktuar.

Monitorimi dhe vlerësimi janë mekanizma të cilët kryhen në intervale kohore duke matur indikatorët e përcaktuar gjatë ofrimit të shërbimit dhe duke vlerësuar impaktin e shërbimeve me qëllim përmirësimin e tyre ndaj përfituesve të shërbimeve shoqërore.

Ngritja e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen si një model i cili pilotohet në nivel vendor e ka shumë të rëndësishëm funksionimin mbi bazën e disa protokolleve të rëndësishme të punës dhe mekanizmave të cilët garantojnë ofrimin në kohë dhe në cilësi të të gjithë gamës së shërbimeve. Për këtë qëllim ngritja e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit duke përcaktuar edhe aktorët përgjegjës garanton zbatimin e instrumentave të nevojshëm që mundësojnë ndërhyrjet e nevojshme në gjurmimin e arritjeve, sfidave dhe sigurimin e evidencave deri në alokimin e burimeve ekzistuese. Proceset

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

monitoruese dhe vlerësuese nëpërmjet raportimit lehtësojnë edhe vendim-marrjen e vazhdimësisë për ofrimin e shërbimit, mbështetjen dhe planifikimin e mëtejshëm.

Aktorët përgjegjës të përfshirë në këtë proces sistematik me qëllim garantimin e cilësisë së shërbimeve janë Bashkia Korçë dhe Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (me mbështetjen e UNCEF) të cilët kanë zhvilluar procedurat dhe manualët për menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjithë shërbimeve sociale të ofruara në territorin e bashkisë nga shërbim ofruesit publikë dhe privatë. Në fazën e pilotimit të shërbimeve këto dy aktorë luajnë një rol të rëndësishëm në dhënien dhe transmetimin e modelit më të përshtatshëm të ngritjes së mekanizmit të vlerësimit dhe monitorimit.

Procesi i monitorimit zbatohet në dy nivele:

1. Mekanizmi i monitorimit dhe vlerësimit të SHMFF nga vetë pushteti vendor, përkatësisht Drejtoria e Kujdesit Social pranë Bashkisë Korçë.

SHMFF ka në proces monitorimi performancën e shërbimit nga instrumentat e zgjedhur të Bashkisë Korçë nëpërmjet njësisë së posaçme e cila është përgjegjëse për prezantimin, mbikqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit përfshirë edhe aspektin gjinor, bazuar në standartet vendore ose standartet minimale kombëtare. *(Modeli i Monitorimit dhe vlerësimit është një dokument që bashkë shoqëron protokollin e punës.*

2. Mekanizmi i monitorimit dhe vlerësimit të SHMFF në nivel qendror, përkatësisht me Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror në Korçë dhe vetë Shërbimi Social Shtetëror .

SHMFF gjithashtu do të monitorohet bazuar në legjislacionin e shërbimeve shoqërore nga Shërbimi Social Shtetëror nëpërmjet strukturave të njësisë qendrore dhe drejtorive rajonale. Gjithashtu në këtë proces SHSSH vlerëson nevojat e raportuara nga SHMFF. *(Annex Raportimi)*

Të dy instrumentat e sipërpërmendur ndihmojnë në ofrimin e kornizës gjithëpërfshirëse të mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit duke e kthyer modelin e pilotuar si një praktikë model në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Në procesin e monitorimit do të përfshihen edhe aktorë të tjerë, të cilët do të angazhohen në zbatimin e këtij projekti si dhe ata të listuar me detyrën e monitorimit të Planit Social (ku përfshihen edhe drejtori të tjera të bashkisë dhe Grupi i Dialogut Social me Shoqata jo-publike partnere). Gjithashtu monitorimi parashikon edhe marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime si edhe bën të mundur parashikimin e vështirësive para se të shfaqen. Ai kryhet në intervale kohore mujore, tremujore, gjashtëmujore, vjetore dhe kërkon informacion nga tre fusha kryesore:

- Inputet, burimet që përdoren për realizimin e planit, që përfshijnë ekipin, financat, materialet dhe kohën;
- Proceset, numri i aktiviteteve ku përdoren burime njerëzore dhe financiare për të arritur rezultatet e pritshme;

Protokollin e punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

- Outpute/produkte/shërbime, rezultatet e menjëhershme që përfitohen përmes realizimit të aktiviteteve.

SHMFF është në varësi, dhe raporton tek Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Social në Bashkinë Korçë. SHMFF propozon çdo vit indikatorët e performancës dhe raporton në mënyrë periodike, të paktën 2 herë në vit, pranë Drejtorisë së Kujdesit Social. Përgjegjësi i SHMFF-së do të jetë anëtar i Grupit të Dialogut Social të ngritur në Korçë. Për qëllimet e këtij aplikimi indikatorët e performancës mbi të cilët do bëhet raportimi dhe vlerësimi janë si më poshtë:

Indikatori 1: Ngritja e SHMFF dhe funksioneve të saj

Indikatori 2: Ofrimi i programeve mbështetëse për familjet në nevojë – 160 familje

Indikatori 3: Ofrimi i programeve për fuqizimin e familjes/prindërim pozitiv – rreth 150 familje

Indikatori 4: Shtresa në nevojë (individë dhe familje) me të informuara për te drejtat e tyre – numri i fushatave ndërgjegjesuese dhe informuese per çështje te shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Mjetet për monitorim mund të jenë: analizat statistikore, vizitat monitoruese pranë SHMFF, pyetësorë drejtuar përfituesve të shërbimeve, fokus grupe me aktorë të ndryshëm, apo informatorë të tjerë kyç.



Aneke:

Aneksi 1- Rolet dhe përgjegjësitë e ekipit të SHMFF

Përgjegjësi/sja i/e Shërbimit në SHMFF

1. Garanton për çdo përfitues ofrimin e shërbimeve profesionale, gjithëpërfshirëse, në përputhje me ligjet dhe me standardet për shërbimet sociale dhe procedurat e përcaktuara në legjislacion;
2. Siguron liderшипin e duhur, mbështet dhe nxit zhvillimin e ekipit nëpërmjet trainimeve, seminareve, si edhe inkurajon ndarjen/shkëmbimin e njohurive;
3. Përgatit, në bashkëpunim me punonjësit e tjerë të ekipit, planin ditor e javor të veprimtarive të organizuara dhe miraton planin e punës për secilin.
4. Koordinon dhe bashkërendon punën e ekipit të SHMFF për realizimin e veprimtarive ditore, detyrave dhe programeve të miratuara;
5. Propozon mënyrën për organizimin e programeve edukative, argëtuese, krijuese, kulturoreartistike dhe sportive, në funksion të shërbimeve për fëmijët, të rinjtë dhe familjarëve të tyre.
6. Kujdeset për koordinimin e tyre dhe dukshmërinë;
7. Jep udhëzime, ndihmon dhe monitoron veprimtarinë e secilit nga anëtarët e ekipit;
8. Kujdeset për çdo vlerë materiale, aset që garanton funksionimin e qendrës, kujdeset për mirëmbajtjen, higjenën (dizinfektimin) e ambientit, ruajtjen e pajisjeve dhe materialeve si dhe për sigurinë e qendrës;
9. Dokumenton dhe raporton sipas specifikave në mënyrë të rregullt.
10. Mban komunikim të rregullt me Drejtorinë e Ndihmës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe ekipin e NISMA ARSIS për çështje të ndryshme
11. Ndjek dhe monitoron procesin e dokumentimit të punës dhe raporton në mënyrë periodike tek eprorët e vet.
12. Përgjegjësi/ja është anëtar dhe drejton punën e ekipit multidisiplinar dhe ndjek në mënyrë të rregullt ecurinë e rasteve;
13. Njeh dhe zbaton me profesionalizëm dokumentacionin e punës së qendrës (rregulloren e brendshme, politikat e ekipit, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes kundrejt shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodit të sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të Bashkisë për të cilin duhet të ketë dijeni).

Psikologu/ia për të rritur

1. Identifikon problematikat/vështirësitë, nevojat si dhe të mundësojë trajtim të mëtejshëm psikologjik (në rastet kur është e nevojshme) për anëtarët e rritur të familjeve;



BASHKIA KORÇË

2. Njeh dhe zbaton teknikat profesionale/metodat psikologjike në krijimin e marrëdhënieve dhe trajtimin në vazhdimësi të rastit, bazuar në besim dhe respekt në përputhje me etikën profesionale;
3. Realizon plan individual ndërhyrjesh dhe vlerëson objektivat terapeutikë në aspektin funksional, emocional dhe psikologjik të individit;
4. Dokumenton periodikisht informacionin individual të vlerësimit të individit, në dosje elektronike dhe hard copy;
5. Dokumenton të gjitha procedurat e ndjekura në trajtimin e rastit;
6. Përgatit raportet dhe vlerësimet individuale për çdo rast dhe ecurinë për gjithë kohën e qëndrimit në shërbim, mënyrën e zgjidhjes së problematikave të rasteve në trajtim, mbështetur edhe në bashkëpunimin me profesionistët e tjerë në shërbim.
7. Është anëtar i ekipit multidisiplinar dhe ndjek në mënyrë të rregullt ecurinë e rastit;
8. Njeh dhe zbaton me profesionalizëm dokumentacionin e punës së qendrës (rregulloren e brendshme, politikën e ekipit, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes kundrejt shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodit të sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të Bashkisë për të cilin duhet të ketë dijeni).

Psikologu/ia për fëmijë

1. Kryen vlerësimin e fëmijëve dhe nevojave të tyre psikologjike;
2. Identifikon problematikën/vështirësitë, nevojat si dhe të mundësojë trajtim të mëtijshëm psikologjik (në rastet kur është e nevojshme);
3. Njeh, identifikon dhe adreson vështirësitë në fushat e zhvillimit për çdo fëmijë;
4. Njeh dhe zbaton teknikat profesionale/metodat psikologjike në krijimin e marrëdhënieve dhe trajtimin në vazhdimësi të rastit, bazuar në besim dhe respekt në përputhje me etikën profesionale;
5. Realizon plane individuale ndërhyrjesh dhe vlerëson objektivat terapeutikë në aspektin funksional, emocional dhe psikologjik të fëmijës;
6. Dokumenton periodikisht informacionin individual të vlerësimit të fëmijës, në dosje elektronike dhe hard copy;
7. Dokumenton të gjitha procedurat e ndjekura në trajtimin e fëmijës;
8. Përgatit raportet dhe vlerësimet individuale për çdo rast dhe ecurinë për gjithë kohën e qëndrimit në shërbim, mënyrën e zgjidhjes së problematikave të rasteve të paraqitur/mbështetur edhe në bashkëpunimin me profesionistët e tjerë në shërbim.
9. Është anëtar i ekipit multidisiplinar dhe ndjek në mënyrë të rregullt ecurinë e rastit;
10. Njeh dhe zbaton me profesionalizëm dokumentacionin e punës së qendrës (rregulloren e brendshme, politikën e ekipit, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes kundrejt shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodit të sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të Bashkisë për të cilin duhet të ketë dijeni).



Punonjësi/ja Social/e për Fuqizimin e Familjes

1. Vlerëson të gjitha rastet në nivel shumë dimensional, për të kuptuar gjerësisht nevojat dhe ndërton planin e ndërhyrjes për familjet dhe fëmijët në shërbime;
2. Punon ngushtësisht mbi:
 - a. krijimin e një marrëdhënieje besimi me fëmijët dhe familjen,
 - b. vlerësimin e nevojave,
 - c. vizitat në familje,
 - d. këshillimin,
 - e. orientimin e anëtarëve të familjes drejt shërbimeve specifike,
 - f. orientimin dhe këshillimin me familjet dhe fëmijët në mënyrë individuale dhe në grup
3. Vlerëson dhe monitoron në vazhdimësi përparimin e përfituesit sipas qëllimeve dhe objektivave të matshme, të përshkruara në planin e trajtimit dhe kujdesit pjesë e PIZH;
4. Punonjësi social është anëtar i ekipit multidisiplinar dhe ndjek në mënyrë të rregullt ecurinë e rastit;
5. Punonjësi social bashkërendon punën me profesionistë të tjerë për të vlerësuar gjendjen socialekonomike, shëndetësore ose fizike të përfituesve për koordinuar ndërhyrjen në mbështetjen ndaj nevojave të tyre;
6. Referon dhe ndërlihd me burimet në komunitet apo shërbimet e ofrura nga institucionet shtetërore për të siguruar mbështetje të tilla si ndihmë financiare, strehim, arsim, dhe punësim;
7. Advokon për përfituesit në përfshirjen në sistemin e shërbimeve të mbrojtjes sociale;
8. Është anëtar i ekipit multidisiplinar dhe ndjek në mënyrë të rregullt ecurinë e rastit;
9. Njeh dhe zbaton me profesionalizëm dokumentacionin e punës së qendrës (rregulloren e brendshme, politikën e ekipit, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes kundrejt shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodit të sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të Bashkisë për të cilin duhet të ketë dijeni).

Punonjësi/ja Social/e për Klasat e Prindërimit

1. Ndërmer veprime me synim rritjen e potencialeve të familjes përmes fokusit të fortë në zhvillimin e kapaciteteve prindërore, marrëdhënieve mes tyre dhe rrjetit të mbështetjes sociale;
2. Vlerëson nevojat dhe riskun duke u konsultuar me të gjitha dokumentet, përfituesin, kolegët e EMD dhe në rastet komplekse me të gjithë aktorët e përfshirë duke kryer një proces vlerësimi të plotë;
3. Ndërvepron me familjen dhe punon për lidhjen e familjes me gjithë burimet e aksesueshme komunitare dhe orientimin e tyre drejt profesionistëve që punojnë në shërbime universale (shëndetësi dhe edukim) si dhe shërbime të specializuara, sikurse dhe drejt burimeve të tjera të siguruar nga autoritetet vendore, rajonale apo kombëtare;



BASHKIA KORÇË

4. Informon dhe jep këshilla bazë për të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, informim bazë mbi pagesat dhe përfitimet sipas specifikave të rasteve;
5. Ndërvepron ngustësisht për realizimin e programeve të edukimit prindëror duke trajnuar prindërit në teknikat e menaxhimit të sjelljes, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë personale të përballimit të sfidave dhe arritjen e rezultateve pozitive;
6. Ofron ndërhyrje e cila përfshin sigurimin e veprimtarive të strukturuar që ndihmojnë në përmirësimin e lidhjes së prindërve me fëmijët, për shembull, bashkëpunim për trajnimin e prindërve në lojëra të posaçme terapeutike për të përmirësuar lidhjen e prind-fëmijë dhe për të përmirësuar sjelljen e fëmijëve sidomos kur këta të fundit manifestojnë probleme në sjellje apo të natyrës psikiatrike;
7. Punonjësi social i SHMFF do të referojë në institucionet dhe agjensitë që ofrojnë “In kind support” familjet që nuk plotësojnë nevojat bazë.
8. Është anëtar i ekipit multidisiplinar dhe ndjek në mënyrë të rregullt ecurinë e rastit;
9. Njeh dhe zbaton me profesionalizëm dokumentacionin e punës së qendrës (rregulloren e brendshme, politikat e ekipit, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes kundrejt shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodit të sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të Bashkisë për të cilin duhet të ketë dijeni).

Kujdestare Shtëpie për Familjet e Fëmijëve në IPSH

1. Ndihmon familjen në organizmin e një rutine ditore të shëndetshme që përfshin kohën cilësore të kaluar së bashku;
2. Aftëson anëtarët e rritur të familjes në lidhje me përmbushjen e nevojave të kujdesit shëndetësor për veten dhe fëmijët;
3. Aftëson anëtarët e rritur të familjes në menaxhimin e të ardhurave;
4. Mbështet nënat të reja në kujdesin ndaj foshnjeve;
5. Ofron mbështetje dhe orientim drejt marrjes së shërbimeve mbështetëse private ose publike sipas nevojës së familjes;
6. Organizon dhe ndjek aktivitete ndërgjegjësuere në bashkëpunim me komunitetin;
7. Harton kalendarin e aktiviteteve me objektiva të qarta, kohëzgjatja e aktivitetit dhe rezultatet e pritshme;
8. Kryen aktivitete që ndihmojnë anëtarët e rritur të familjes të plotësojnë nevojat e tyre bazike me synim mirëmbajtjen dhe zhvillimin e nivelit të mirëqenies, duke nxitur pavarësinë e tyre;
9. Qëndron në shtëpinë e familjes ose bën vizita periodike për të monitoruar nëse planifikimi i shërbimeve mbështetëse është përshtatur plotësisht me nevojat e familjes (në varësi të nevojave të identifikuara).
10. Është anëtar i ekipit multidisiplinar dhe ndjek në mënyrë të rregullt ecurinë e rastit;



BASHKIA KORÇË

11. Njeh dhe zbaton me profesionalizëm dokumentacionin e punës së qendrës (rregulloren e brendshme, politikat e ekipit, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes kundrejt shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodit të sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të Bashkisë për të cilin duhet të ketë dijeni).

Kujdestare Shtëpie për Kujdesin Alternativ dhe familjet me PAK

1. Kujdestare shtëpie për kujdesin alternativ dhe familjet me PAK punon në grup ose individualisht, kryesisht në këto drejtime:
2. Marrëdhëniet dhe socializimi;
3. Rritja e kapaciteteve në fushën e autonomisë;
4. Rritje e kapacitet në drejtim të shërbimit ndaj vetes dhe ndaj ambientit ku jeton;
5. Rritja e kapacitetit të funksionimit në komunitet;
6. Ndhmon familjen në organizmin e një rutine ditore të shëndetshme që përfshin kohën cilësore të kaluar së bashku;
7. Aftëson anëtarët e rritur të familjes në lidhje me përmbushjen e nevojave të kujdesit shëndetësor për veten dhe fëmijët;
8. Aftëson anëtarët e rritur të familjes në menaxhimin e të ardhurave;
9. Ofron mbështetje dhe orientim drejt marrjes së shërbimeve mbështetëse private ose publike sipas nevojës së familjes;
10. Diskuton në mënyrë periodike temat sociale me të rriturit apo fëmijët me aftësi të kufizuara, duke stimuluar pjesëmarrjen e tyre aktive.
11. Kujdestari do të jetë përgjegjës për marrëdhënien e personave të përfshirë në programin e jetesës së pavarur në komunitet.
12. Është anëtar i ekipit multidisiplinar dhe ndjek në mënyrë të rregullt ecurinë e rastit;
13. Njeh dhe zbaton me profesionalizëm dokumentacionin e punës së qendrës (rregulloren e brendshme, politikat e ekipit, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes kundrejt shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodit të sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të Bashkisë për të cilin duhet të ketë dijeni);

Sanitar

1. Ruan e trajton me kujdes vlerat materiale e dokumentet zyrtare gjatë rregullimit e pastrimit të ambjenteve të zyrave;
2. Për çdo problem ose shqetësim që konstaton gjatë kryerjes së detyrës, në mjediset e qendrës, njofton menjëherë përgjegjës/in/en;
3. Në mënyrë periodike kërkon tek Sektori i Administratës nevojat materiale për kryerjen me cilësi të detyrave që i ngarkohen si: lëndët e pastrimit që i nevojiten gjatë punës së saj, si: detergjente për pastrim dysHEMEJE, pllakash; detergjente për larje veshjesh, për larje enësh etj.



BASHKIA KORÇË

4. Përgjigjet për mirëmbajtjen, higjienën dhe pastërtinë e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të qendrës. Ajo pastron: dyshemenë, dyert, dritaret, pllakat e tualeteve; tryezat, karriget, kompjuterët dhe vegla të tjera të punës; lavamanet, bidetë, pllakat e dusheve dhe të tualeteve, kryen mbledhjen /heqjen e mbeturinave;
5. Respekton fëmijët dhe përfituesit e rritur dhe kujdeset për parimet etike të komunikimit me përfituesit dhe ekipin;
6. Njeh dhe zbaton me profesionalizëm dokumentacionin e punës së qendrës (rregulloren e brendshme, politikat e ekipit, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes kundrejt shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodit të sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të Bashkisë për të cilin duhet të ketë dijeni).

Aneksi 2: Nevojat e identifikuar dhe kriteret e aksesit në shërbim

Kohëzgjatja e secilës fazë të procesit të punës me rastin do të përcaktohet nga karakteristikat e fëmijës dhe familjes, si dhe nga kompleksiteti i nevojave që duhet të adresohen. Puna me rastin do të funksionojë si një proces i përcaktimit të synimeve, ndërhyrjes, monitorimit dhe rivlerësimit në përputhje me ndryshimin e nevojave të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre. Procesi i menaxhimit të rastit do të duhet gjithashtu të lidhë familjet me shërbimet sociale dhe komunitetin.

Menaxhimi i faktorëve të riskut dhe ofrimi i mundësive për të përmirësuar zhvillimin dhe rritur reziliencën individuale dhe familjare janë faktorë kyç drejt sigurisë, qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të fëmijëve. Këta faktorë mund të lidhen me karakteristika individuale, mund të gjenden në familje, mund të lindin si pasojë e mungesës së mbështetjes dhe shërbimeve publike e private, apo mund të gjenden në komunitet.

Shembuj të faktorëve të riskut lidhur me kapacitetin prindëror përfshijnë:

- Marrëdhënien me fëmijën;
- Aftësitë jo të përshtatshme prindërore;
- Mungesa e disiplinës në prindërim;
- Vendodhjen gjeografike, distanca nga shërbimet;
- Edukimi i prindit dhe papunësia;
- Varësia nga sistemi i shërbimeve shoqërore;
- Varfëria;
- Sëmundje seksualisht të transmetueshme;
- Jetë seksuale jo e përshtatshme/shëndetshme;
- Problematika të shëndetit (sëmundshmëria);
- Abuzim me substancat;
- Aftësi të kufizuara;
- Probleme të shëndetit mendor;
- Konflikti dhe dhuna në familje;

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

- Historiku i abuzimit dhe neglizhimit;
- Trauma;
- Historik i rritjes në institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror.

Kriteret e përcaktimit të nevojave dhe fushat në të cilat do të bazohet përfshirja e përfituesve në shërbime do të jetë e orientuar sipas fushave të paraqitura në tabelën më poshtë:

Nevoja me rëndësi të lartë

Shëndeti	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fëmijët me nevoja të veçanta ose aftësi të kufizuar të cilët kanë nevojë të lartë për mbikqyrje të vazhdueshme, kjo mund të rezultojë në prishjen e familjes. ✓ Situata në të cilat kujdesi fizik ose mbikqyrja e fëmijës neglizhohet së tepërmi. ✓ Fëmijë të cilët keqpërdorin substanca. ✓ Fëmijë të cilët dëmtojnë seriozisht veten e tyre.
Emocionale, sociale, sjellore	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fëmijë me sjellje tepër sfiduese të cilat rrezikojnë vetë fëmijën ose të tjerët dhe që prindërit nuk e menaxhojnë dot, kjo mund të rezultojë në prishjen e familjes. ✓ Fëmijë të cilët përjetojnë refuzim të lartë emocional nga prindërit ose kujdestarët ku përfshihen pritshmëritë jo realiste, prindërimi jo i qëndrueshëm
Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fëmijë të cilët kanë nevojë për kujdes jashtë familjes së tyre. ✓ Fëmijë të cilët kanë pësuar prishje të marrëdhëniës me prindërit ose kujdestarët. ✓ Fëmijë me aftësi të kufizuara ku prindërit ose kujdestarët nuk janë në gjendje të përballojnë nevojat e fëmijës dhe ku nuk ka kujdestarë të tjerë të mundshëm për fëmijën.
Mjedisi i fëmijës	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fëmija po jeton në një mjedis ku ekziston rreziku ose ku po ndodh dhunë ekstreme në familje. ✓ Mjedisi dhe higjiena e shtëpisë rrezikojnë të dëmtojnë fëmijën në mënyrë të menjëhershme.
Faktorët prindëror	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Prindërit ose kujdestarët vuajnë nga gjendja e rëndë mendore, fizike ose kanë vështirësi në të nxënë dhe nuk arrijnë të kujdesen në mënyrë të përshtatshme për fëmijën. ✓ Prindërit ose kujdestarët konsumojnë alkool ose substanca të tjera, keqpërdorimi i tyre ndikon drejtpërdrejtë në mirëqënien e fëmijës.

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



Nevoja me rëndësi të mesme

Shëndeti	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fëmijë të cilët jetojnë në një mjedis i cili mund të paraqesë rrezik për sigurinë dhe mirëqënien e tyre. ✓ Fëmijë me një nivel të lartë të nevojave të veçanta, prindërit e të cilëve nuk mund të plotësojnë nevojat e tyre pa mbështetje të vazhdueshme. ✓ Kujdesi fizik ose mbikqyrja e fëmijës është e papërshtatshme.
	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fëmijë të cilët herë pas here dëmtojnë veten e tyre. ✓ Fëmijë të cilët nuk kanë patur mbrojtje ose kujdes të përshtatshëm.
Emocionale, sociale, sjellore	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fëmijë me sjellje tepër sfiduese të cilat prindërit nuk janë në gjendje t'i përballojnë pa mbështetje të vazhdueshme. ✓ Fëmijë me sjellje të cilat i mënjanojnë ata ose provokojnë refuzimin e të tjerëve. ✓ Fëmijë të cilët janë të përfshirë në sjellje të paligjshme dhe për të cilat ka procese gjyqësore. ✓ Fëmijë të cilët kanë përgjegjësi për t'u kujdesur ndaj të tjerëve dhe për të cilët këto përgjegjësi ndikojnë në zhvillimin e tyre.
Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fëmijët të cilët kanë patur kujdes jashtë familjes së tyre. ✓ Fëmijët të cilët kanë patur kujdes dhe që tanimë kanë nevojë për shërbime pas kujdesit të ofruar. ✓ Fëmijët të cilët janë në rrezik të prishjes së marrëdhëniës me prindërit ose kujdestarët. ✓ Fëmijët të cilët kanë patur disa njerëz brenda rrethit familjar që janë kujdesur për ta, por kjo ka krijuar paqëndrueshmëri dhe pasiguri për fëmijën.
Mjedisi i fëmijës	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fëmija po jeton në një mjedis ku ka një historik të incidenteve apo dhunës në familje. ✓ Mjedisi ose higjena e shtëpisë e vendosin fëmijën në rrezik dëmtimi.
Faktorët prindëror	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Prindërit ose kujdestarët kanë paaftësi ose kanë një historik me probleme të shëndetit mendor ose vështirësive në të nxënë, të cilat prekin dhe aftësinë e tyre për t'u kujdesur për fëmijën. ✓ Prindërit ose kujdestarët janë konsumues të alkolit ose keqpërdorin substanca të cilat ndikojnë në aftësinë e tyre për t'u kujdesur për fëmijën. ✓ Prindërit të cilët kanë sjellje kriminale ose/dhe antisociale të cilat rrezikojnë mirëqënien e fëmijës.



Nevoja me rëndësi të ulët

Shëndeti	<ul style="list-style-type: none">✓ Fëmijët me disa nevoja të veçanta që kërkojnë referim për shërbime të tjera p.sh. Vizita shëndetësore, Logoped.✓ Fëmijët që shfaqin shenja të sjelljes të cilat i vendosin ata në rrezik.
Emocionale, sociale, sjellore	<ul style="list-style-type: none">✓ Fëmijët që kanë pak mundësi të takohen dhe të luajnë me fëmijë të tjerë për shkak të izolimit të prindërve. Mund të kërkojë referim në një Qëndër për Familjen, këshilla në grupet e lojës, klubet e mbështetjes pas-shkolle etj.
Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore	<ul style="list-style-type: none">✓ Fëmijët që përjetojnë norma të paqëndrueshme të prindërimit, por zhvillimi i të cilëve nuk është dukshëm i dëmtuar.✓ Fëmijët, prindërit e të cilëve kërkojnë këshilla dhe udhëzime për të menaxhuar sjelljen e tyre.✓ Mund të kërkojë referim për në grupin e prindërimit
Mjedisi i fëmijës	<ul style="list-style-type: none">✓ Prindërit / kujdestarët kanë vështirësi kronike/të përsëritura në marrëdhëniet e tyre, të cilat mund të ndikojnë tek fëmija.✓ Familja ka nevojë për këshillim dhe mbështetje lidhur me ngacmimet me bazë etnike.



Aneks 3: Formularët e vlerësimit

FORMULARI I VLERËSIMIT TË NEVOJAVE ¹²	
Emri i individit (fëmijës/ familjes)	Nr. i regjistrimit (kodi): Rast i ri _____ Rast i përsëritur/ asistuar _____
Mosha/data e lindjes: Gjinia _____	Data kur është bërë referimi pranë SHMFF
Të dhëna për familjen dhe kontakte:	Njësia Bashkiake _____ Vendbanimi _____ Vendqendrimi _____ Përkatësia/etniciteti _____ Shtetësia _____
Arsyeja e referimit të rastit në SHMFF	Vlerësimi është bërë nga: Përgjëgjës i SHMFF _____ Punonjës social _____ Psikolog _____ Edukator _____ Mjek/infermier _____ PMF _____ Të tjerë _____
	Koha e kryerjes së vlerësimit

¹² Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes", aneksi 6 I përshtatur



BASHKIA KORÇË

Agjensitë/komuniteti/personat në kontakt me fëmijën/familjen	Të tjera
--	----------

Situata aktuale : Sfondi familjar/përmbledhje e historive të fundit/ngjarje kritike: *(plotësohet nga punonjësi social, psikologu në bashkëpunim me NJVNR/PMF/ SDHF)Çfarë ka ndodhur me fëmijën që nga momenti i identifikimit proaktiv dhe aktualisht gjatë procesit të vlerësimit. Njëkohësisht duhen pasqyruar dhe ndërhyrjet që janë realizuar për të nxjerrë fëmijën/familjen nga situata emergjente.*

(Propozoj qe te jete vete historiku i familjes nga identifikimi - mardheniet me institucionet, komunitetin, familjen dhe femijet)

Vlerësim i fëmijës :Zhvillimi dhe mirëqenia e fëmijës (fizike, emocionale, njohëse, shëndetsore, shpirtërore etj. dhe çdo nevojë tjetër e veçantë, p.sh., aftësia e kufizuar)
Secila rubrike plotësohet nga specialisti përkatës, i cili përdor instrumentat bazuar në protokollet e punës së gjithësecilit.

Vlerësimi i nevojave të sigurisë/çështje ligjore/niveli i rrezikut

Vlerësimi i nevojave shëndetësore dhe rekomandim (fëmijë dhe familje)
(Çështje të shëndetit : informacion që ka lidhje me shëndetin që nga çasti i lindjes e deri në momentin aktual. Nëse fëmija është i vaksinuar, nëse ndiqet rregullisht për çështjet shëndetësore, nëse ka ndonjë sëmundje të veçantë, nëse ka pasur ndonjë dëmtim apo lëndim si thyerje, plagë të pashpjegueshme etj.;)

Vlerësimi i nevojave psikologjike dhe rekomandim (Çështjet psikologjike: (sjellja, emocionet, trauma, etj)

Vlerësimi i nevojave psiko-sociale dhe rekomandim (prezantimi social, aftësitë e vetpërkujdesit)



BASHKIA KORÇË

Vlerësimi i marrëdhënies së fëmijës me familjen (pikat e forta)dhe rekomandim (këtu mblidhet informacion për gjithë aspektet shoqërore si p.sh. kush janë shokët/shoqet me të cilët qëndron fëmija, nëse ka pasur ndonjë ndryshim kohët e fundit etj. Si dhe vlerësimi i gjithë marrëdhënies së fëmijës me prindërit, vëllezërit, motrat, të afërm të tjerë që janë pranë fëmijës, gjyshër, kushërinj ose ndonjë i afërm me të cilin fëmija është më i lidhur;)

Vlerësimi i nevojave arsimore dhe rekomandim informacion nëse fëmija ndjek çerdhen, kopshtin, shkollën si dhe çështje të lidhura me mbarëvajtjen e tij/të saj, si mungesat, ndonjë ndryshim në sjellje, mbarëvajtje në mësim, me shokët etj.;

Histori të mëparshme abuzimi Është e nevojshme të referohet i gjithë informacioni mbi situatë të mëparshme abuzimi ndaj fëmijës

Këndvështrimet/dëshirat e fëmijës: edhe ky është një aspekt thelbësor i vlerësimit, pasi përdoret për të marrë informacion të drejtpërdrejtë nga fëmija mbi këndvështrimin e tij mbi situatën, shpjegimet e tij rreth saj, si dhe dëshirat e tij për jetën e vet;

Vlerësim i familjes (bazuar në informacionet, ndërveprimet, komunikimet me familjen apo aktorë të tjerë)

Vlerësimi i kapacitetit të prindërimit dhe aftësia për ta përballuar (Sa të aftë janë prindërit për të ushtruar prindërimin, për tu siguruar

- kujdes bazë,
- sigurimi i mbrojtjes për fëmijët,
- ngrohtësi emocionale,
- stimulim
- udhëzime dhe vendosje kufijsh
- stabilitet në jetën e tyre
- stabilitet

Vlerësimi i shëndetit mendor dhe fizik/aftësi e kufizuar



BASHKIA KORÇË

Vlerësimi Psikologjik i anëtarëve të familjes
Statusi ligjor i anëtarëve madhorë të familjes
Vlerësim i funksioneve familjare (marrëdhëniet dhe dinamikat) ku duhet të përfshihet edhe situata e fëmijëve (në rast se ka) të tjerë në familje. Si është marrëdhënia mes prindërve, personave të rritur në familje, prind-fëmijë, ndarje, divorce, largime, bashkëjetesa, partner të njërit prind me fëmijën, etj..
Kushtet e jetesës dhe situata ekonomike/e punësimit: (këtu përfshihet vlerësimi për strehimin, mjedisin ku jeton fëmija, ku fle, kushtet e higjienës, ushqimit, etj, si dhe vlerësohen aspektet e të ardhurave, financave të familjes etj;
Mbështetje nga familja/komuniteti i gjerë: Si është mbështetja nga familjarët e tjerë, familja e gjerë, fqinjët, anëtarët e komunitetit, grupe fetare, grupe komunitare, etj
Histori të mëparshme abuzimi në familje: <i>Është e nevojshme të referohet i gjithë informacioni mbi situatë të mëparshme abuzimi të ndodhur në familje</i>
Mendimet e prindërve/kujdestarëve , familjarëve, persona të interesuar , mbi situatën apo trajtimin e problemit ky është një aspekt mjaft i rëndësishëm i vlerësimit, pasi përdoret për të marrë informacion drejtpërdrejt nga prindërit/kujdestarët për problemet me të cilat përballen, si dhe shpjegimet për të kuptuar se pse ndodhen në atë situatë
Alternativa të tjera mbështetëse/Burime shtesë/mbështetja e disponueshme



BASHKIA KORÇË

<p>Pikat e forta të Fëmijës dhe Familjes: <i>ky aspekt i vlerësimit synon të sjellë informacion për pikat e forta të fëmijës dhe familjes, të cilat mund të mbështeten më tej dhe të shërbejnë si burime për të ndihmuar fuqizimin e fëmijës dhe marrëdhënien e tij me familjen</i></p>
<p>Informacione të tjera të nevojshme:</p>
<p>Përmbledhje e vlerësimit mbi situatën e fëmijës/familjes dhe rekomandime për ndërhyrje dhe trajtim</p>

Aneksi 4 – Formular i vizitës në familje

Formulari i vizitës në familje është një instrument pune që përdoret nga punonjësi social por edhe nga profesionistë të tjerë për të dokumentuar informacionin që mbledh gjatë kryerjes së vizitës në familje. Kjo formë plotësohet sa herë kryhet vizita në familje. Edhe në rastet kur nuk ka ndryshime në kushtet e banesës, plotësohen rubrikat që shpjegojnë dinamikën gjatë kryerjes së vizitës. Në rastet kur është planifikuar vizita në familje dhe nuk realizohet, pavarësisht se ju keni shkuar tek banesa, sugjerohet që formulary te plotësohet në rubrikat e fundit dhe te jepet shpjegimi.

Formular për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime ¹³		
DATA / ORA:	MBIEMRI I FAMILJES:	PUNONJËSIT:

¹³ Vendim I Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, aneksi



BASHKIA KORÇË

Kush është i/e pranishëm/e:				
	Nuk ka shqetësim	Ka pak shqetësim	Ka shumë shqetësime	Komente / Shënime
Mjedisi Fizik				
A është e përshtatshme shtëpia? Për shembull ka hapësira të mjaftueshme? A ka ujë pa ndërprerje / tualet? A është mjaftueshëm e ngrohtë?				
A është shtëpia e pastër dhe e rregullt? A ka ndonjë tregues që mund të ketë rreziqe për shëndetin e fëmijës?				
A ka një vend të përshtatshëm për fëmijën ku të flejë?				
A ka rreziqe fizike të dukshme? Për shembull xhama, thika dhe objekte të mprehta që gjenden rrotull ose pranë një rrugë të ngarkuar?				
A ka lodra të disponueshme që përshtaten me moshën e fëmijës?				
Vëzhgimi & Sjellja e Fëmijës				
A është i veshur fëmija në mënyrën e duhur?				
A është i pastër fëmija?				

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare"(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

**BASHKIA KORÇË**

<i>Duke mbajtur parasysh moshën e fëmijës, a i përmbushin ata etapat e një zhvillimi normal?</i>				
<i>A është ndërveprimi i fëmijës me ju i përshtatshëm, duke mbajtur parasysh moshën e tyre?</i>				
<i>A është e folura dhe gjuha në përputhje me moshën e tyre?</i>				
<i>A luan fëmija / a e mbush kohën e tij / saj në mënyrën e duhur?</i>				
<i>A i ndjek fëmija udhëzimet / kërkesat?</i>				
<i>A ka shenja abuzimi si p.sh. nxirje ose dëmtime të pashpjegueshme?</i>				
<i>A ka ndonjë sjellje e cila mund të përbëjë shqetësim ose e cila mund të mos duket “normale”?</i>				
Ndërveprimi Prind—Fëmijë				
<i>A ka ndonjë veprim fizik / të përzemërt ndërmjet prindit dhe fëmijës?</i>				
<i>A bën prindi komente pozitive për fëmijën në prani të fëmijës?</i>				
<i>A është ndërveprimi prind – fëmijë udhëzues (kontrollues) apo ata i lënë fëmijës mundësi zgjedhjeje?</i>				
<i>A shihet prindi dhe fëmija në sy?</i>				

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

**BASHKIA KORÇË**

<i>A duket se ka një marrëdhënie të ngrohtë dhe të natyrshme ndërmjet prindit dhe fëmijës (apo fëmija duket i frikësuar / i kujdesur)?</i>				
<i>A duket i lumtur fëmija?</i>				
<i>A duket se ka një dallim të dukshëm në sjellje ose qëndrim ndaj fëmijëve të ndryshëm në familje?</i>				
<i>Nëse ka fëmijë të tjerë në shtëpi, a duket se marrëdhënia mes fëmijëve është e përshtatshme? Ndonjëri nga fëmijët a po dominon ose po ushtron bullizëm ndaj të tjerëve?</i>				
Prezantimi i Prindërve / Adultëve				
<i>A paraqet prindi pritshmëri jorealiste për fëmijën / sjelljen e tyre?</i>				
<i>A flet prindi me negativitet për fëmijën / duket shumë kritik?</i>				
<i>A duket sikur prindi kontrollon tërësisht sjelljen e tyre ose a duken ata sikur janë nën ndikimin e drogës, alkoolit etj.?</i>				
<i>A ka ndonjë shenjë të dhunës në familje brenda familjes?</i>				
<i>A ka ndonjë shenjë ose a përmendet ndonjë vështirësi në marrëdhëniet ndërmjet adultëve në shtëpi?</i>				

**BASHKIA KORÇË**

A përmend prindi ndonjë sjellje për kujdesin e fëmijës që mund të jetë shkak për një shqetësim? Për shembull ndëshkimi trupor.				
A ka ndonjë gjë të “çuditshme”, ose shqetësuese mbi sjelljen e prindërve që mund të sugjerojë praninë e problematikave të rëndësishme si p.sh. probleme me shëndetin mendor?				
A ishte prindi agresiv / mbrojtës gjatë vizitës?				
PAS VIZITËS/ Vëzhgime				
Cilat ishin dinamikat gjatë vizitës?				
A patët mundësi të flisnit me fëmijën në mënyrë individuale? Nëse po, a keni ndonjë element që do të donit ta trajtonit? ele				
A ka ndonjë çështje / problematikë që ka nevojë të ndiqet/ shërbim kujdesi që duhet ofruar?				
Duke menduar për vizitën në shtëpi a jeni të shqetësuar për mirëqenien / sigurinë e fëmijës? A mendoni që ata janë përballë ndonjë risku? Nëse po, atëherë ju lutem përmendi përse.				

Aneksi 5- Fleta e ditarit

Fleta e ditarit është një instrument pune për të gjithë punonjësit socialë por edhe profesionistët e tjerë gjatë procesit të menaxhimit të rastit. Fleta e ditarit plotësohet me informacion të përmbledhur për veprimet që realizon apo planifikon të kryejë punonjësi social që nga momenti i identifikimit të rastit deri në mbylljen e tij.

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

FLETA E DITARIT ¹⁴			
Rasti ____			
Data/Ora	Metoda e komunikimit (p.sh. përmes telefonit, vizitës, takimit)	Përmbledhje e komunikimit	Veprime të ndërmara ose të sugjeruara

Aneksi 6: Formulari i raportimit për fëmijën në nevojë për mbrojtje

përdoret në të gjitha rastet kur ekipi vlerëson se rasti i fëmijë sparaqet tregues të nivelit të rrezikut, ndaj të cilëve nëse nuk reagohet, fëmija mund të dëmtohet. Kjo formë raportimi i drejtohet Punonjësit të Mbrojtjes së fëmijëve në njësinë administrative.

¹⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes", aneksi



BASHKIA KORÇË

Formular i raportimit për fëmijën në nevojë për mbrojtje ¹⁵		
Emri /identiteti i fëmijës:	Data e lindjes:	Gjinia
Emri dhe adresa e prindit/kujdestarit		Vendndodhja e fëmijës/ vendi ku ndodhet fëmija
Shenjat e abuzimit / neglizhimit/ abuzimit (shenja, sjellje, informacione mbi gjendjen e fëmijës)		Lloji i abuzimit i dyshuar/ konstatuar <input type="checkbox"/> dhunë fizike <input type="checkbox"/> dhunë seksuale <input type="checkbox"/> neglizhim <input type="checkbox"/> dhunë psikologjike <input type="checkbox"/> shfrytëzim ekonomik <input type="checkbox"/> trafikim <input type="checkbox"/> fëmijë në situatë rruge
Të dhëna të tjera mbi situatën e fëmijës: <i>Përmbledh informacione të tjera që sugjerojnë se fëmija është në situatë rreziku dhe burimin e rrezikut</i>		
Arsyet për raportim: Shqetësimi për mbrojtjen e fëmijës:		
Emri dhe detajet e personit që ka bërë identifikimin	Emri dhe detajet e personit që bën raportimin	
nënshkrimi	Emri dhe detajet e personit/ institucionit që merr raportimin	Formulari është dërguar Email: _____ Postë: _____

Aneksi 7- Formular për identifikimin proaktiv

Ky formular plotësohet në momentin që përfituesi paraqitet vetë për të marrë shërbime pranë SHMFFsë, apo kur ekipi i SHMFF gjatë punës në terren bie në kontakt me rastin.

¹⁵ Vendim I Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes", aneksi



BASHKIA KORÇË

Formular për identifikimin proaktiv

Data	Ora	Punonjësi
Njësia Bashkiake:		
Bashkia:		
Vendndodhja:		
Forma përmes së cilës është bërë identifikimi: <input type="checkbox"/> vizita në terren <input type="checkbox"/> paraqitja e vetë personit Njoftim nga : <input type="checkbox"/> person fizik/juridik <input type="checkbox"/> punonjësi i institucioneve publike dhe private <input type="checkbox"/> medias së shkruar, elektronike, medias sociale		
Emri i fëmijës/prindërve/kujdestarit/shoqëruesit		
Mosha e fëmijës _____ Gjinia _____	Fëmijë të tjerë që ndodhen me fëmijën _____	
Të dhëna paraprake mbi situatën në të cilën gjendet fëmija, nevoja për mbrojtje dhe masat që duhet të merren		
Miratimi për dhënien e pëlqimit për referim / marrje shërbimesh _____		
nënshkrimi		

Protokolli i punës për SHMFF Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare”(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



Aneksi 8- Plani i ndërhyrjes për fuqizimin e familjes

Plani i ndërhyrjes për fuqizimin e familjes është i hartuar si dokument që të përmbajë disa rubrika. Sugjerohet që secila rubrikë të përmbajë aktivitetet e ndërmarra për plotësimin e nevojave të secilit anëtar të familjes

Plani¹⁶ i ndërhyrjes për fuqizimin e familjes _____

Emrat e anëtarëve të familjes të përfshirë në planin e fuqizimit		
Aktorët e përfshirë në hartimin e planit (Emri, pozicioni i punës/organizata/ institucioni):		
Data e hartimit të planit:		

Dimensionet – Nevojat specifike të identifikuar	Rezultatet e dëshiruara/objektivat	Aktivitetet sygjera	Personat/agjensitë përgjegjëse	Afatet kohore të sugjeruara	Treguesit dhe Monitorimi	Kosto
Shëndeti i familjes (trajtimi i problemeve shëndetësore fizike/mendore të cilat lidhen me mundësitë e punësimit dhe aftësinë për përkujdes)						

¹⁶ Plani i ndërhyrjes për fuqizimin e familjes është i hartuar si dokument që të përmbajë disa rubrika. Sugjerohet që secila rubrikë të përmbajë aktivitetet e ndërmarra për plotësimin e nevojave të secilit anëtar të familjes.



BASHKIA KORÇË

Kushtet e jetesës së familjes <i>(përfshirë orendi shtëpiake, energji elektrike, uji, kanalizime, ristrukturime, etj):</i>						
Situata ekonomike <i>(bazuar në kapacitetet e anëtarëve madhorë dhe kontekstit kulturor familjar):</i>						
Situata ligjore e familjes <i>(mospagesa e faturave të OSHE-së, çështje gjyqësore të hapura, etj)</i>						
Punësimi <i>(alternativa për aftësim profesional, punësim dhe mikroiniciativa):</i>						
*Nevoja ligjore të familjes :						



BASHKIA KORÇË

Dinamikat familjare:						
-----------------------------	--	--	--	--	--	--

Aftësitë për prindërim <i>(kurse prindërimi dhe rindërtimi i marrëdhënies prind-fëmijë):</i>						
Edukimi i prindërve <i>(kurse profesionale, etj):</i>						
Edukimi i fëmijës <i>(regjistrimi fëmijës në institucionet arsimore, dokumentacioni përkatës, komunikim dhe mbështetje nga ekipi dhe komuniteti në shkollë):</i>						
Trajtimi i diskriminimit dhe ceshtjeve të identitetit <i>(lidhur historikut të fëmijës)</i>						



BASHKIA KORÇË

Përshtatja me rikthimin e fëmijës në familje <i>(këshillim/psi koterapi, etj):</i>						
Shëndeti i fëmijës <i>(kalimi i kartelës shëndetësore , kart a e shëndetit dhe vaksinimit</i>						
Ruajtja e marrëdhënieve me bashëkmoshatarët dhe ekipin e ISHP <i>(përfshirë edhe me motrat dhe vëllezërit kur ndodhen ende në ISHP)</i>						
Persona kontakti që duhen kontaktuar në situata krize <i>(plan emergjence)</i>						
Nevoja të tjera specifike <i>(p.sh. konsultime etj):</i>						



ANEKS 9: Shërbimi Emergjent për Mbrojtjen e Fëmijëve gjatë dhe Pas Orarit Zyrtar

Shërbimet emergjente të mbrojtjes së fëmijës gjatë dhe pas orarit zyrtar (SHEMF-POZ) është një shërbim 24-orësh që mbulon të gjithë territorin e bashkisë/qarkut, i cili operon gjatë dhe pas orarit zyrtar dhe është përgjegjës për rastet kur fëmija mund të jetë në nevojë për një ndërhyrje/përgjigje mbrojtëse të menjëhershme dhe se fëmija nuk mund të presë dhe jetë i sigurtë deri në ditën pasardhëse të punës.

SHEMF-POZ pret telefonata dhe raportime për rastet e mundshme nga salla operative e strukturave të policisë (112,129) dhe shërbime të tjera që kanë marrëveshje me shërbimet e emergjencës. SHEMFPOZ i përgjigjet vetëm emergjencave, nëpërmjet ndërhyjes direkte të menjëhershme ose duke koordinuar nëpërmjet telefonit me organizata lokale të shërbimeve në komunitet apo shërbime të tjera me të cilat ka lidhur marrëveshje për një ndërhyrje të tillë. Numri i telefonit, kontaktet e tjera dhe shërbimet e ofruara të SHEMF-POZ janë të afishuara në çdo sallë operative.

Kur është përcaktuar nga SHEMF-POZ se fëmija është në rrezik të qënësishëm dhe të menjëhershëm për t'u dëmtuar dhe ndërhyrja e menjëhershme është e domosdoshme, SHEMF-POZ merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e fëmijës sa më shpejtë që të jetë e mundur. Kur SHEMFPOZ përcakton se ndërhyrja/përgjigjia e menjëhershme nuk është e nevojshme, atëherë rasti do ti referohet në bazë të procedurave përkatëse PMF/NJMF/NJVRN. (neni 13, pika 2)

SHEMF - POZ ka përgjegjësi për fëmijët në nevojë të një përgjigje emergjente edhe pas orarit zyrtar, që janë në rrezik të menjëhershëm për dëmtim të rëndë, dhe janë në një situatë që nuk mund të lihet i sigurtë deri në ditën pasardhëse të punës ose të ditëve pushim apo festave.

Procedura e përgjithshme për ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve në rrezik

Ndihma e menjëhershme përfshin masat dhe veprimet për dhënien e ndihmës në momentin e identifikimit dhe kontaktit të parë, për të garantuar mbrojtje të menjëhershme dhe kujdes parësor për fëmijën në varësi të nevojave të vlerësuara dhe nivelit të rrezikut të përcaktuar.

Ajo përmban tri forma:

Shoqërimi në familje: Skuadra e terrenit pas marrjes së vendimit shoqëron fëmijën në familje bazuar në adresën që jep fëmija dhe duke verifikuar lidhjen familjare. - Plotëson formularin e dorëzimit të fëmijës - *Protokolli i punës për SHMFF* Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare"(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

Informon familjen për situatën dhe i shpjegon procedurën - Informon familjen për detyrimet ligjore që familja ka për kujdesin e fëmijës, etj. - Njofton familjen se rasti do të referohet në NJMF dhe për shërbimet që familja mund të përfitojë nga skemat e ndryshme të ndihmës. - Depoziton formën e dorëzimit dhe në bazë të protokollit referon rastin tek NJMF-ja/Njësia Vendore

Shoqërim në shërbimin shëndetësor të urgjencës: Fëmija shoqërohet në urgjencën e spitalit pediatrik të qytetit/qendër ditore - Plotësohet Proces-verbali i dorëzimit kur fëmija është i pashoqëruar. - Njofton mbikëqyrësin për këtë veprim përmes Formës së Identifikimit dhe Referimit dhe familjarët nëse janë identifikuar. - Referohet rasti tek NJMF-ja përkatëse sipas procedurës së përcaktuar në VKM për menaxhimin e rastit.

Marrje e menjëhershme në mbrojtje e fëmijës: Në rastet kur fëmija është i/e pashoqëruar ose në nivel të lartë rreziku atëherë skuadrat e terrenit duhet të marrin vendim për marrjen e fëmijës në mbrojtje të menjëhershme. Kur fëmija merret në mbrojtje atëherë ai/a jo shoqërohet në Shërbimin e Emergjencës për Mbrojtjen e Fëmijëve, aty ku këto shërbime ekzistojnë.

Shënim: Në rastet kur nuk ka një Shërbim Emergjence për Mbrojtjen e Fëmijëve, atëherë vlerësimi dhe ndihma e menjëhershme mund të jepen nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror aktual apo në SHMFF në të ardhmen. Në të gjitha rastet procesi i vlerësimit do të jetë i njëjtë me atë të shërbimit të emergjencës të shpjeguar më sipër. Fëmija shoqërohet në Shërbimin e Emergjencës në bazë të formularit të dorëzimit të fëmijës. Që nga ky moment SHE vazhdon procedurën si më poshtë:

- Strehim i menjëhershëm deri në 11 ditë nga mbërritja e fëmijës në qendër.
- Mbështetje psiko sociale (fëmijës i lihet koha për t'u qetësuar e kupuar situatën e re në të cilën ndodhet).
- Mbështetje mjekësore dhe higjieno sanitare sipas nevojave.
- Ushqim dhe veshmbathje.
- Marrja e të dhënave administrative edhe kontrollimi i tyre sëbashku me Policinë e Shtetit, DShSbnë, ShSSH/R-në dhe NjMF-në përkatëse sipas rastit.
- Intervista formale me fëmijën pasi fëmija të jetë qetësuar e të jetë gati për të.

Model i ofrimit të shërbimeve të Emergjencës

SHEMF- Pas orarit zyrtar ka staf të gatshëm 24 orë në ditë, por është funksional vetëm pas orarit zyrtar nga ora 16:00 deri në orën 08:00 nga e hëna deri të premten deri në ditën e ardhshme të punës, duke përfshirë edhe 24 orë në fundjavë dhe festat publike. SHEMF-POZ është vendosur pranë SHMFF. Shërbimi ka numrat e tij të kontaktit, të cilat janë të afishuara në të gjitha sallat operative të policisë dhe urgjencave të tjera përfshi ALO 116-111, ashtu sikundër është numri i policisë për referime nga çdo qytetar apo profesionist. Referimet vijnë nga shërbimet e sipërpërmendura nga i gjithë territori në të cilën ushtrojnë aktivitetet SHEMF-POZ.

SHEMF kanë 3 ekupe me nga dy staf me përvojë në mbrojtjen e fëmijëve, secila me një udhëheqës të ekipit, i cili është pritës i referimit qoftë nëpërmjet telefonit ashtu edhe nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit. Ekipet punojnë në bazë të kalendarit të hartuar paraprakisht nga koordinatori i shërbimit.

Protokoll i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



BASHKIA KORÇË

Ekipi i parë është i gatshëm ndërsa ekipi i dytë është rezervë. Ekipi i tretë është pushim ose ndjek rastet gjykatë dhe në institucione të tjera. Ekipet janë të përbëra nga një PMF (punonjës social) dhe një psikolog për fëmijë;

- Punonjësit e ekipeve të emergjencës mund të jenë me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme bazuar në incidencën si edhe në mundësitë financiare të secilës bashki/qark.
- Të gjitha referimet nga çfarëdo burim shqyrtohen me prioritet. Pritësi i referimit kërkon dhe mbledhë sa më shumë informacione që të jetë e mundur;
- Bazuar në informacionin e mbledhur realizohet dhe vendimarrja për ndërhyrje të menjëhershme. Kur nuk ka baza për për të ndërmarrë veprime të menjëhershme referimi rregjistrohet thjeshtë si referim;
- SHEMF do të pranojnë referime nga bashki të tjera kur ka marrëveshje paraprake bashkëpunimi. (kjo vlen për rastet kur shërbime të tilla janë ngritur në nivel qarku);
- Kur kërkohet një ndërhyrje emergjente pas orarit zyrtar SHEMF i kanë kapacitetet e tyre në gadishmëri, qoftë në lidhje me një rast të ri ose ekzistues, qoftë për të bërë një ndërhyrje mbrojtëse, qoftë për t'u përgjigjur në dhënien e informacionit të kërkuar. Ekipet e emergjencës janë të gatshëm për të ndërhyrë edhe në zonat rurale kur është e nevojshme;
- SHEMF ndërmarrin veprime ligjore gjatë dhe pas orarit zyrtar kur rasti nuk mund të jetë i sigurtë deri në ditën pasardhëse të punës. Kjo përfshin masat e menjëhershme të mbrojtjes, të konfirmuara nga drejtuesi/koordinatori direkt i shërbimit, si edhe plotësimin e kërkesave për urdhër mbrojtjeje nga gjykata.

Mbështetja psiko-sociale dhe Shoqërimi/ Referimi i Fëmijëve në SHEMF

Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës lidhur me të miturin dëshmitar dhe viktimë, i cili do të jetë në përputhje me situatën e vlerësuar nga Polica dhe ai/ajo vetë gjatë prezencës në intervistimin e të miturit/es në Hapësirën Miqësore për të Miturit në përputhje me KDPM.

Ekipi i cili do të asistojë të miturin gjatë intervistimit do të përbëhet nga një Psikolog i Liçensuar dhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve, si dhe mbështetja logjistike nga një mjet lëvizës. Ky ekip do të funksionojë 24/7 ditë të javës në bazë të një kalendari të paracaktuar dhe do të njoftohet në numrin e telefonit që do të ndahet me Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe/ose Policinë.

Në momentin që Oficeri I Policisë Gjyqësore në bashkëpunim me Ekipin e emergjencës do të vlerësojnë në interesin më të lartë të fëmijës, vendosjen e fëmijës në një SHEMF, ata do të plotësojnë Proçesverbalin për Marrjen në Mbrojtje të Menjëhershme të Fëmijës dhe proçesverbalin e shoqërimit të standartizuar (aneksi nr.10, VKM 578). PMF dhe/ose OPGJ-ja do të njoftojnë menjëherë SHEMF në numrin e telefonit të ndarë për pritjen e fëmijës.

Fëmija do të shoqërohet nga Ekipi i Komisariateve dhe një përfaqësues i policisë dhe më pas nëpërmjet një porçesverbali dorëzimi të standartizuar, do të vendosin fëmijën në SHEMF.

Ekipi i emergjencës do pajisë me informacion fillestar ekipin e turnit, si dhe do të ofrojnë mbështetje në lehtësimin e vendosjes së fëmijës në SHEMF.

Protokoll i punës për SHMFF Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare"(Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) *Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS*



Shërbimet e strehimit të sigurtë, emergjent, të përkohshëm (SHSES) për fëmijët

PMF, SPSHSB në bashki dhe SHSES janë përgjegjëse për vendosjen/strehimin gjatë dhe pas orarit zyrtar të fëmijëve në rrezik të menjëhershëm në SHSES, duke mbuluar të gjithë territorin e bashkisë. Ky shërbim ju përgjigjet të gjitha kërkesave që vijnë nga institucionet dhe shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve edhe më gjerë brenda dhe jashtë orarit zyrtar. SHSES ngrihen me vendim të këshillit bashkiak në çdo bashki dhe ose kur ka marrëveshje bashkëpunimi midis disa bashkive mund të jetë edhe një SHSES për qark. Qëllimi i këtij shërbimi është të sigurojë shërbim strehimi të sigurtë të përkohshëm për fëmijë në rrezik të menjëhershëm për dëmtim të rëndë.

SHSES ofrohen kur një fëmijë deri në 18 vjeçështë në rrezik për dëmtim real dhe të menjëhershëm. SHSES sigurojnë kujdes rezidencial (statutor) brenda bazës/kornizës ligjore, me kohë të kufizuar edhe kundra vullnetit të fëmijës kur jeta e fëmijës është në rrezik. Pas pranimit të një fëmije, realizohet plotësimi i nevojave immediate, jetësore, nevojave fizike shëndetësore, zhvillohet një plan gjithëpërfshirës për të zvogëluar rrezikun dhe për t'i mundësuar fëmijës sipas rastit, vendosjen në mënyrë të sigurtë në kujdes alternativ, jashtë familjes biologjike/kujdestare nëse kjo vlerësohet si e nevojshme /përshtatshme.

Shërbimet shëndetësore u ofrohen fëmijëve të strehuar në SHSES nga ofruesit aktualë të shërbimeve shëndetësore si urgjenca mjekësore, qendrat shëndetësore dhe spitale bazuar në vlerësimet dhe nevojat e fëmijës. Fëmijët e strehuar në SHSES përballen me ndryshimet fizike, konjitive, psikologjike dhe sociale dhe sfida të tjera që zakonisht lidhen me këtë fazë të jetës. Megjithatë, në dallim nga shumica e fëmijëve, shpesh fëmijët e abuzuar, shfrytëzuar, neglizhuar, pa kujdes prindëror, rritur në rrugë etj, kanë probleme komplekse, të shumta shëndetësore dhe varësie, veçanërisht të përdorimit të drogës, alkolit, prirje për sjellje kriminale, sjelljeve me rrezikshmëri të lartë dhe probleme të shëndetit mendor. Adresimi i këtyre nevojave dhe sigurimi i ndihmës është i dobishëm për të ndihmuar fëmijët të jenë të sigurtë dhe të mbrojtur.

Grupi i përfituesve janë fëmijë të moshave 0-18 vjeç të cilët janë në rrezik të menjëhershëm për t'u dëmtuar rëndë dhe për të cilët nuk ekziston asnjë alternativë e sigurtë e kujdesit alternativ. Fëmijët duhet të jenë subjekt i një urdhër mbrojtje ose mase mbrojtëse.

Struktura për shërbimet sociale pranë bashkisë ose organizatat me bazë komunitare ose institucione fitimprurëse të nënkontraktuara nga bashkia është përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi.

Shërbimi i strehimit të sigurtë emergjent të përkohshëm

- Kur rreziku i dëmtimit (përfshirë dëmtimin e grumbulluar) është vlerësuar si shumë i lartë për fëmijët për të qëndruar, jetuar në shtëpi me prindërit, SPSHSB nëpërmjet PMF-së, mund të vendosë marrjen e fëmijës në mbrojtje dhe vendosjen e tij/saj në SHSES për të siguruar mbrojtjen dhe mirëqenien e tyre, ndërsa adresojnë problemet që kanë shkaktuar këtë situatë;
- Institucionet/organizatat që ofrojnë këto shërbime janë entitete më vete por financohen dhe ose janë në marrëdhënie shërbimi me bashkinë. Në të gjitha rastet SPSHSB ka përgjegjësinë për monitorimin e standarteve të shërbimit;



BASHKIA KORÇË

- Bazuar ne LDMF dhe LSHKSH Institucionet/organizatat menaxhojnë dhe ofrojnë një sërë shërbimesh për të siguruar interesin më të lartë të fëmijës;
- Në të ardhmen SHSES mund të ofrohet edhe nga familje kujdestare të kualifikuara/trajnuara për të ofruar shërbime të tilla, bazuar në standartet specifike të ndryshme nga standartet e familjeve të zakonshme kujdestare.